



Regjistri i sendeve të gjetura në varrezat masive në Serbi

1. Batajnica 01 [BA01]

1.1 Ekshumimi dhe autopsia e trupave: 12 - 27. juna 2001

1.2 Ekipi i Institutit të Mjekësisë Ligjore- Beograd:

Profesor dr. Dušan Dunjić, dr.Tanja Atanasijević, dr.Vesna Đokić, dr.Đorđe Alempijević, profesor Slobodan Savić, antropologët profesor dr. Marija Đurić dhe asistent dr. Danijela Đonić dhe arkeolog Andrej Starović, Stacioni hetues Petnica.

1.3 Vëzhguesit:

Prof. Marti Valter (Marty Walter), patolog nga Zvicra, Vilijam Fulton (William Fulton), hetues i Tribunalit të Hagës, Kevin Kertis (Kevin Curtis), shef i ekipit hetues të Tribunalit të Hagës, Brenda Kenedi (Brenda Kennedy), drejtoreshë e ekipit forenzik dhe dr.Mark Skinner (Mark Skinner), antropolog forenzik – Komisioni ndërkombëtar për persona të zhdukur (ICMP) dhe Mojca Shivert, Fondi për të drejtën humanitare.

1.4 Terreni:

Varreza masive - Batajnica 01 gjendet në terrenin sportiv SAJ MPB e Serbisë “13 Maj”, 100 metra larg Danubit dhe rreth një kilometër në jug nga rruga Beograd – Batajnica. Në njerën anë të terrenit gjendet rruga e pashtuar dhe në anën tjetër tunelet për kultivimin e këpurdhave. Varreza ka një sipërfaqe prej 2.40 x 7,00 metra. Pas ekshumimit dhe autopsisë trupat janë vendosur në frigorifer, të cilët pastaj janë mbyllur dhe bllobuar në tunelin për kultivimin e këpurdhave të Kombinatit Bujqësor në Beograd, pranë Danubit afër terrenit SAJ. Përveç trupave, në tunel janë vendosur edhe sendet personale të gjetura në lokacionin Batajnica 01 .

1.5 Parametrat identifikues:

Letërnjoftimi i gjetur në xhupin ngjyrë kaltër në emër të **Fatmire (Vesl) Berisha** nga Suhareka , e lindur më 1975 në Suharekë, numri i letërnjoftimit 78149, i lëshuar më datën 10.06.1998.

Letërnjoftimi dhe libreza shëndetësore në emër të **Hamdi (Sahit) Berisha** nga Suhareka, i lindur më 1945 në Suharekë, me pjesën e qartazi të dukshme dukshme të numrit amë 1107946.

Letërnjoftimi brenda rrobave të shkapërderdhura në emër të **Musli Berisha** nga Suhareka, i lindur më 1940 në Suharekë.¹

Letërnjoftimi në emër të **Nexhmedin Berisha** nga Suhareka, i lindur ne vitin 1962 në Suharekë.²

¹ Dëshmia e Vilijam Fultonit në procedurën kundër Slobodan Millosheviqit 28.maj. 2002 FHP, dokumentacioni

² Njejtë

Patent shoferi në emër të **Zoga Mehdi** nga Suhareka.³

1.6 Garderoba dhe sendet:

Në varrezë janë gjetur pjesë të rrobave dhe sendet jashtë trupit. Çdo pjesë e robave është shënuar si GL “garderobë e lirë “ dhe është vendosur në qese me shenjat BA SG I deri BA SG VIII.

1.7 Pjesët e rrobave :

Fanela e bardhë me vija të gjelbëra dhe yje të bardhë; një copë shajaku; jelek; xhup lëkure; fanelë

1.8 Sendet e lira:

Syze; orë dore

1.9 Parametrat identifikues, rrobat dhe sendet e gjetura në trupa:⁴

Letërnjoftimi në emër të **Afrim (Musli) Berisha** nga Suhareka, nr 64933, JMBG 0304974952016, i lëshuar më 29.05.1995, numri serik CP 09339573 – trupi BA-09,⁵ Disa dokumente në emër të **Vesel Berisha** nga Suhareka i lindur në vitin 1938 në Suharekë- trupi BA-22,⁶

Patika ngjyrë të bardhë me vija të zeza në këmbën e djathtë⁷ -trupi BA 38;

Letërnjoftimi dhe patent shoferi në emër të **Hasan Bytyqi, i** lindur më 1954 në fshatin Rashtan, Suharekë – trupi BA-56⁸.

2. Batajnica 02 [BA02]

2.1 Ekshumimi dhe autopsia e trupave: 16 korrik deri më 21 shtator 2001.

2.2 Ekipi i Institutit i Mjekësisë Ligjore- Beograd:

Profesor dr. Dušan Dunjić, profesor dr. Miroljub Obradović, docent dr. Ivanka Baralić, dr. Đorđe Alempijević, dr. Dragan Ječmenica, antropolog profesor dr. Marija Đurić, zëvendës: asistent dr. Slobodan Nikolić dhe asistent dr. Snežana Pavlekić, ndihmës gjatë autopsisë, Redžep Mamutovski dhe Ljubisav Bordejašević dhe tekniku i kriminalistikës MPB Petar Ilinçiq.

2.3 Vëzhgues :

Vilijam Fulton (William Fulton) hetues i Tribunalit të Hagës, dr. Mark Skinner (Mark Skinner), antropolog forenzik, Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (ICMP), Liljana Bogdanović dhe Silvija Panović- Đurić, OSBE dhe Iris Bjelica, Fondi për të Drejtën Humanitare .

³ Njejtë

⁴ Të gjitha parametrat identifikuesë, rrobat dhe objektet janë të shënuara me numrin e trupit në të cilin janë gjetur.

⁵ Dëshmia e Viliam Fultonit në procesin kundër Slobodan Millosheviqit, 28 Maj 2002 FHP, dokumentacioni

⁶ Ibid. V. Fulton në dëshminë e vet nuk thekson saktësisht për të cilag dokumente është fjala.

⁷ Patologët e Institutit për Mjekësinë Gjyqësore kanë supozuar se është fjala për trupin e fëmijës me një patikë në këmbën e djathtë

⁸ Dëshmia e V. Fultonit në procesin kundër Slobodan Millosheviqit, 28 Maj 2002. FHP dokumentacioni.

2.4 Terreni:

Lokacioni i varrezës Batajnica 02. gjendet 300m larg Danubit. Varreza ka një sipërfaqe prej rreth një ari. Të gjithë trupat, si dhe gjërat dhe rrobat e gjetura janë vendosur në tunelin në afërsi të qendrës policore sportive “ 13 Maj “

2.5 Pjesët të rrobave:

Xaketë meshkujsh me astar nga gëzofi artificial, në xhepin e së cilës është gjetur një filxhan i deformuar ushtarak nga alumini dhe mbeturinat e xhaketës;brek të gjata pëlhere;jelek nga materiali ngjyrë vjollce me lara të kuqërreme;një pjesë e duksit të fëmijës, ngjyrë të bardhë me lara, në pjesën e përparme me mbishkrim “ LITTLE ANGELES”;duks i fëmijes me fotografinë “ Borëbardha dhe shtatë xhuxhat”;duksi me mbishkrimin“SPEED THE CAR THE PLANE THE TRAIN”

2.6 Copët të mbathjeve:

Një palë këpucë lëkure të zeza, të cekëta me lidhëse, me shollë gome, nr.44;një palë mokasina të zeza nga lëkura me maje, nr.43;një palë mokasina të zeza me fjongë lëkure me shollë gome;një palë këpucë lëkure, të zeza,me lidhëse, të cekëta, nr.43;një palë këpucë të thella lëkure, ngjyrë kafe, me lidhëse, me pjesë metali, me shollë plastike, me shenjën “ CAT” në gjuhëzën e këpucës;një palë çizme të shkurta gome, me astar, me mbërthesë përbrenda, nr.42;një palë këpucë lëkure të thella, ngjyrë kafe, shollë gome, me lidhëse;nje palë mokasina, lëkurë të zezë, nr.44, në pjesën e përparme me lëkurë;një palë patika lëkure, ngjyrë të bardhë dhe e zezë, gjysëm të thella, të markës “ Victory”;një palë këpucë lëkure, të zeza, me lidhëse, me shollë plastike, nr.41, te nyelli i këmbës pjesë të ngjitura nga pëlhura;një palë këpucë lëkure, ngjyrë të kuqe, me lidhëse,të cekta, nr.44; një palë patika, të thella lëkure, ngjyrë bardh-zi në nyell në anën e pasme amblema “MD”; 3 palë këpucë të shkyera, nga lëkura me shollë të trashë, 2 të majta dhe një e djathtë;një patikë e majtë.

2.7 Sende të ndryshme:

3 dërrasa, 2 nga druri (të dimensioneve 2m x 25cm) dhe një nga alumini (të dimensioneve 1,5 cm x 8 cm);

2 dërrasa të dimensioneve 2m x 20 cm njëra me ngjyrë të kaltër;

pllaka ushtarake me shenjë 30.06.1980-Esmaine Llazi-Tiranë, një kapelë dhe përforcuesi metalik për çizme.

një copë gome të plastifikuar me mbishkrimin “Delagat i Partisë Socialiste të Serbisë”,

një sasi e madhe e metalit dhe telit;

pjesë të kamionit, dy pjesë të dyerve të pasme të frigoriferit, goma të mëdha, pompa si dhe unaza metalike, që janë të zakonshme për tenda;

një qese me 2-3 kg sheqer të bardhë.

2.8 Parametrat identifikuese, veshja e gjetur në trupa⁹:

Një këmbë e pantallonave dhe një pjesë e tyre, pjesë e brekëve, një pjesë e xhaketës, këpuca e majtë me çorapë – trupi 2BA -03;

Një orë dore, libri i gjuhës angleze dhe libri i matematikës në gjuhën shqipe - trupi 2BA-47;

⁹ Të gjithë parametrat identifikues, veshja dhe gjërat të cilat janë të shënuara me numrin e trupit ku janë gjetur.

Një protezë e dhëmbëve komplet (e sipërme dhe e poshtme), dy krehër plastikë – i bardhë dhe i verdhë, mprehëse lapsash – trupi 2BA-77;

Një monedhë prej 100 dinarësh, dy lapsa kimikë, letër me vizatime të fëmijëve dhe numra të telefonit, një tub gjysëm i zbrazët i ilaçit “Ketonal” – trupi 2BA-82;

Letërnjoftimi në xhepin e brendshëm të majtë të setrës në emër të **Ali (Kadri) Bajrami**, i lindur më 20.5.1942, në Madanaj, JMBG 2005942940009. Numri i letërnjoftimit 122488, i lëshuar më 20.10.1992. në KK Gjakovë, fshati Skivjan, një orë nga metali ngjyrë hiri me vija ngjyrë të verdhë – trupi 2BA-92;

Një rreth metalik - trupi 2BA-97;

Një urë metalike e dhëmbëve në nofullë, një rrip metalik i orës - trupi 2BA-98;

Një pjesë e rripit me vegëza, një pjesë e xhinsave të kaltër, pantollona të mbyllt prej shtofi me vija të holla të kuqe për së gjati, xhinsa të kaltër me rrip të gjërë dhe katramë masive, pjesë të brekëve prej frotiri, pjesë të slip-brekëve të meshkujve (me bazë të qelë dhe me vija të kaltra e të kuqe për së gjati), një pjesë e brekëve të larjës dhe një mangë e xhemperit të punuar me dorë - trupi 2BA-99;

Një qese prej pëlhure me 1000 DM, një pjesë e shokës së xhinsave me etiketën në të cilën shkruante: « M VINCI CASUAL», një pjesë e xhemperit të zi me jakë «zhakar», këmishë ngjyrë vjollce-bezh dhe xhemperi ngjyrë të verdhë i punuar me dorë - trupi 2BA-100

Pjesë të xhemperit-punim dore, ngjyrë e kuqe e mbyllët dhe e dhezët, një orë dhe unazë (burmë) – trupi 2BA-101;

Një orë - trupi 2BA-104;

Një pjesë e rripit të kaftë policor me katramëz katrore në formë të pllakës me mbërthim karakteristik të dyfishtë – trupi 2BA-103/2BA-91
(me analizën antropologjike është konstatuar se kemi të bejmë me një trup);

Një faculetë pëlhure me skaje të qëndisura me pe të kuq, një pjesë e veshjeve sportive-trenerkave ngjyrë kaltër të mbyllët ose të zezë, xhinsa të kaltër me rrip dhe xhaketë (fajerka) – trupi 2BA – 105;

Xhemperi ngjyrë të verdhë (bezh) me vija tirkizi dhe të kaltra për së gjati si dhe mbeturinat e nënkishës dhe të brekëve- trupi 2BA-106;

Duks ngjyrë hiri me jakë, një xhemper ngjyrë kuqërremë, punim makine, në të cilin ishte thurrur mbishkrimi «MARTIME» dhe një fanellë e kuqërremë me vija të kaltra për së gjati – trupi 2BA-107;

Mbeturina të xhinsave të kaltër prej kadifeje me rrip të zi, mbeturinat këmishës së shtofit ngjyrë e kaltër e mbyllët me jakë të xhemperit me vija gjeometrike – trupi 2BA-10

Një katramëz metalike shpatuke e rripit – trupi 2BA-109;

Një xhemper i murrëm me pulla, këmishë e zezë teksas dhe një xhaketë me ostar – trupi 2BA-110;

Një duks i zi-i -gjelbër – trupi 2BA-111;

Një xhaketë sintetike me ostar, këmishë e shtofit karo me katrorë të kuqe, të zeza e të gjelbra, një duks i murrëm me një copë të ngjitur dhe me mbërthyes në pjesën e sipërme dhe një këpucë e cekët ngjyrë gështenje me lidhëse me mbishkrimin «HAPPY SHOES». Mbeturinat e djegura të kartëmonedhave((2x200, 3x100 i 1x10 DM) dhe një orë - trupi 2BA-114;

Proteza e poshtme e dhëmbëve (e tëra), një setër teget prej shtofi me një rend pullash, një çizme e zezë-sintetike e veshur me gëzof sintetik, një palë pantallona të kaltër prej pëlhure, (nëpër vegëza ishte i vendosur litari), një këmishë e zezë prej shtofi me vija ngjyrë vjollce dhe e kuqe e mbyllët që formojnë katrorë, çorapë të leshta të thurrura me dorë, xhemper ngjyrë vjollce i punuar me makinë, çorapë ngjyrë ulliri, fanelë me mëngë

(pjesë të uniformës ushtarake), dy foli të ilaçit «Ranitan» (“zdravilo za ukus, Lek Ljubljana”), mprehes , syze me dioptri, një llambë me bateri, krahër (i vogël, prej plastike, ngjyrë gështenje) dhe një shishe me pluhur mtë bardhe me kapak prej çeliku-trupi 2BA-116;

Patent shoferi, leje qarkullimi për traktor dhe rimorkio, kartoni i kontrollit teknik dhe një dhëmb ari i nofullës. Dokumentet janë në emër të Hysni Ibrahimimi, i lindur më 6.07.1959, JMBG 06079940004, fshati Nivokaz KK Gjakovë, i lëshuar në SHPB Gjakovë, më 6.04.1993, nr. i patent shoferit 12839. Leja e qarkullimit për traktor dhe rimorkio është lëshuar në të njëjtin emër (i matkës IMT -539, me ngjyrë të kuqe me nr. e regjistrimit DJ 20-38 i datës 1.8.1989. NJë xhemper ngjyrë gështenje me me vija katrore të kuqërreme, jelek i punuar me dorë, xhemedan me astar me lara, një çelës i vjetër, shkrepëz, rrip metalik ore (nga ana e pasme në orë është ngulitur projektili), makinë për prerjen e thonjëve dhe zhiletë – trupi 2BA-117;

Dy rruza ngjyrë vjollce në xhepin e xhaketës sintetike së zezë dhe duksi i zi me vija të gjëra të kuqe në gjoks dhe në skaje- pranë trupave-2BA-118 dhe 2BA-119¹⁰;

Kartëmonedha prej 10 frankash zvicerane në mbeturinat e setrës-trupi 2BA-128

Kartëmonedha prej 40 DM - trupi 2BA-134;

Krahër plastik ngjyrë gështenje dhe dy shishe me ilaçe (pa etiketë) - trupi 2BA-135;

Një unazë (rreth), një orë me rrip metalik ngjyrë të verdhë në të murrme dhe një krahër plastike i kaltër – trupi 2BA – 136;

Një xhaketë e zezë prej lëkure me mbërthyes zingjiri dhe me ostar të zi prej mëndafshi, me etiketën «HAPPY LIFE», një duks i gjelbër me jakë ruse dhe me vegëza në pjesën e përparme, në anën e përparme në pjesën e poshtme gjendeshin dy vija të kaltra me mbërthyes zingjiri dhe me mbishkrimin «KOLUMBIA» të shkruara me shkronja të kuqe, pjesa e sipërme dhe e poshtme e veshjeve sportive «ADIDAS» me tri vija të tërthorta ngjyrë të verdhë dhe me shkronja të bardha, një kapelë e murrme e punuar me makinë me skaj të kthyer dhe me mbishkrimin «WER DIE WAHL HAT HAT Weihnachten», brekë të larjes të verdha tirkiz me vija – trupi 2BA-136;

Një duks i gjelbër në të kuqërremë në të cilin, me katrorë të kuq me skaje të gjelbra me mbishkrimin «NIKE», veshje sportive e mbyllët në të kaltër pa shenja karakteristike, një nënkëmishë e zezë «WRANGLER» dhe brekë të larjes ngjyrë të gjelbër-kaltër me vija – trupi 2BA – 139;

Mprehëse metalike, një orë me zingjir, çibuk druri, gërshërë me plastikë të zezë, dy tuba konop, dy lapsa kimikë, një kapelë, një prerëse të thonjve, fashë dhe një tanzistor i verdhë prej plastike me tetë bateri alkalike me forcë 1,5v dhe një litar për pastrimin e armës – trupi 2BA – 140;

Mbeturinat e orës së dorës të shkrirë – trupi 2BA-148;

Dy palë pantallona, brekë të gjata, çorapë dhe një pjesë e patikës që nuk i dihen ngjyra e madhësisë – trupi 2BA-150;

Mbeturinat e xhaketës së zezë prej lëkure – të gjetura në trupin 2BA-151;

Një duks ngjyrë gjelbër-kaltër në të cilin ishte e shkruar «SMAILE» me shkronja nga vizatimi me ngjyrë të zezë-kuqërreme-kuq e mbyllët-gjelbër, duks i zi me shkronja të thurura në formë ovale ngjyrë të kuqe në të mbyllët dhe të gjelbër në të cilin ishte e shkruar «KEINO» me mbërthyes zingjiri me mbajtës në formën e shkronjës latine «B» dhe në mes me dy kaproj në vrap me ngjyrë të kuqërreme, brekë të gjata të përhimta, këmishë e kuqërreme me etiketën nga skaji ngjyrë gështenje në të cilën ishte shkruar «CLUB 15», mbeturinat e xhaketës së mbyllët me astar të kuq në të mbyllët dhe një duks me një vizatim të shtypur me kënd të drejtë ngjyrë të kuqërreme – trupi 2BA-152;

¹⁰ Vëzhguesi i FDH nuk ka konstatuar qartazi se pranë cilit trup janë gjetur sendet e përmendura..

Një orë – trupi 2BA-153;

Një pjesë e mëngës së xhaketës së djegur, e zezë prej pëlhere me astar të zi prej mëndafshi, një pjesë e materialit ngjyrë të gjelbër (sipas të gjitha gjasave mbeturinë duksi) dhe mbeturina pantallonash shtofi ngjyrë të kaltër – trupi 2BA-154;

Xhaketë ngjyrë vjollce me mbërthes zingjiri metalik dhe me mbyrthyes zingjiri tërthorazi në xhep, me tegel të gjelbër të kornizuar, në pjesën e shpinës e shkyer në dy vende (në gjysmën e djathtë dhe të majtë) dhe me emblemë të gjelbër e qepur me pe ngjyrë gështenje në të cilën shkruan “GF 1907”, një xhaketë sintetike e kaltër me mëngë të bardha me dy vija teget për së gjati me lastik të pospular rreth qafe, mëngë dhe skaje të xhepave ngjyrë të kaltër-bardh-kuq, një duks prej pambuku ngjyrë kaltër-kuqërreme, shoka e xhinsave të zi me rrip të gjërë dhe katramëz metalike, pjesë të brekëve të gjata të zeza, një këmishë shtofi me kutia ngjyrë zi-kaltër dy xhepat e përparëm të së cilës kanë kapakë dhe nga një pullë dhe etiketë të bardhë në të cilën është e shkruar me të verdhë “FOSTERS”, një pjesë të xhinsave të kaltër, një orë me akrep në formë piruni – trupi 2BA-156;

Kapelë e zezë shtofi - beretë – e gjetur në trupin 2BA-158;

Këmishë e kuqërreme me katrorë të imët ngjyrë gështenje, këmishë flaneli me katrorë të mëdhenj kuq- e - zi me një pullë karakteristike ngjyrë të gjelbër-kuqërreme, një xhaketë pëlhere me bazë të kuqërreme me një vizatim karakteristik dhe me llastik rreth brezi - trupi 2BA-159;

Një zingjir ari – trupi 2BA-170;

Një pjesë e xhaketës prej pambuku ose duksi ngjyrë të mbyllët, një pjesë e xhaketës sintetike ngjyrë gjelbër të mbyllët – të gjetura pranë trupave 2BA-163 dhe 2BA-163a (në qese gjendeshin eshtrat që u përkisnin personave të ndryshëm të moshave të përafërta);

Një orë (e deformuar) – trupi 2BA-164;

Një duks teget me mbërthyes zingjiri në pjesën e përparme, një fanellë ngjyrë gështenje me mëngë të gjata me prerje ovale dhe brekë të gjata frotiri, këmishë e hollë me ngjyrë të verdhë me lara të zhdrejta të gjerbra, të kaltëra dhe të verdha, një palë çorapë të gjelbra me kutia, duks ngjyrë të kuqe e mbyllët me jakë të rrumbullakët, kurse në pjesën e majtë është shkruar me shkronja të bardha «QUATRRO AMICT» me emblema të tri personazheve, pjesa e poshtme e veshjeve sportive (trenerkë) teget me astar të bardhë me shkronja dhe shenjën «REEBOK», në pjesën e epërme të së cilës ka një xhep të tërthortë, një xhaketë ngjyrë gështenje me astar mëndafshi të gjelbër me tegel të zi në kind, këpucë të zeza të cekëta me lidhëse me hollë gome që ka vija tejet të theksuara të kornizuara në pjesën e poshtme «BOSS-made in Italy», një zingjir ari -trupi 2BA-172;

Një pjesë e protezës së dhëmbëve, një unazë e trashë ari me pllakëz poashtu të trashë, mprehëse lapsash, një orë në futrolë prej perlave të zeza me sjetulla të qepura prej perlëzave të bardha, një shkrepëz, një prerëse e thonjve, zhilet-trupi 2BA-176

46. dy letërnjoftime dhe vërtetimi i punës: letërnjoftimi në emër të **Simon (Ibrahimi) Sokoli**, i lindur me 13.03.1962 në Radonjiq, KK Gjakovë, JMBG 1303962940028, nr. Inj. 10528, i lëshuar më 27.12. 1990, nga SPB Gjakovë dhe letërnjoftimi (nuk është i dukshëm emri personal) **Sokoli** i lindur më 31.01.1965, JMBG 3101965945018, fshati Jahoc KK Gjakovë, nr. i letërnjoftimit 32775, lëshuar më 27.01.1998 nga SPB Gjakovë. Vërtetimi mbi punën i lëshuar nga ana «Juteks holding korporata sh.a.» nga Gjakova (emri i palexueshëm). Një dinar metalik i oksiduar, regjistër emërash, 2 fotografi të vogla dhe 2 të mëdha të të njejtit person femër, një unazë e trashë prej ari, të holla (5x100 dhe 1x500 DM) dhe dy letërnjoftime. Në këllëfin e letërnjoftimit është gjetur busti i Zonjës së Bekuar me fëmijë nga legura metalike-trupi 2BA-177;

Letërnjoftimi (në brendësi plotësisht i palexueshëm) JMBG 190797594011, nr.i letërnjoftimit 112388, i lëshuar më 14.11.1991, kurse vendi ku është lëshuar është i palexueshëm. Një këmishë kadifeje ngjyrë tirkizi, brekë të gjata pambuku ngjyrë të verdhë, çorapë pambuku të përhimë në të zeza, slip-brekë meshkujsh me vija të kaltëra-gjelbëra me bazë të bardhë, një këmishë pambuku teget me mengë të gjata dhe një këmishë pambuku ngjyrë vjollce me mengë të shkurtër me një lule të madhe të shtypur ne pjesën e perparme nryrë të verdhë dhe me shkronja të kaltra specifike kaligrafike-trupi 2BA-179;

Një xhaketë e zezë me astar të gjelbër dhe me pulla dhe me xhepa të qepur anash me kapakë dhe me uçkur në pjesën e brezit me etiketën «TRADITIN», nën të cilën ishte e shkruar me shkronja të kuqe»

”GDC-safe, comfortable, delight” e madhësisë «M», një xhemper punim dore ngjyrë ulliri e çelë me grykë të rrumbullakët, një këmishë pëlhure me mengë të gjata ngjyrë gështenje-të zezë me pulla të kuqe dhe me xhepa me mbërthyes zingjiri dhe një setër me motive peshku nga shtofi i trashë me mbërthesë njëpalëshe ngjyrë gështenje, një krahër, mprehëse, çibuk dhe dy lapsa kimikë dhe një grafik – trupi 2BA-185

Libreza shëndetësore e lëshuar më 1965 në emër të **Rama(Hazir) Sezair/Rama (Hazir) Sezair**, i lindur më 3.12.1963 në fshatin Moliq, KK Gjakovë, një trastë me sende. Në xhepin e jashtëm të përparëm kishte dy brusha të dhëmbëve të thyera, dy qirinj, fashë, dy sapuna (të markës «FAKS» dhe «FRESH»), një shishe e vogël xhami me raki, një pastë e harxhuar kaladonti, krahër plastike ngjyrë trëndafili dhe një qese prej pëlhure me mbërthyes zingjiri në të cilën ishte e shkruar «OCEAN TRIP CRUISE». Në këtë qese janë gjetur foli të hapave «navalgetan» dhe «acetisal», një pastë e vogël «hloramfenikol», ampula «buskopan», 3 qese shamponë dhe një bankënotë prej 50 dinarësh. Brenda trastës janë gjatur një çantë e zezë lëkure femrash, çorapa frotir të bardha me vija ngjyrë trëndafili dhe të gjelbër, çorapë hullahop të zeza për femra, çorapë frotir të bardha me vija ngjyrë trëndafili të dhezët, patika të bardha fëmijësh të markës «WIAX» me vija të kaltra, një fanellë meshkujsh me mëngë të shkurta, në pjesën e përparme mbishkrimi me shkronja të bardha «ADIDAS», çorapë të plota meshkujsh me ngjyrë të gjelbër, një nënkëmishë e rendomtë e bardhë meshkujsh në pjesën e përparme të së cilës ishte shtypur shenja në formë trekëndëshi në të cilën shkruante «CRAIZY LIFE» me madhësi të «M», çorapë najlloni me ngjyrë të gjelbër dhe të kaltër, brekë të gjata fëmijësh të gjelbra, një bluzë pambuku me mëngë të shkurtra me ngjyrë të kuqe në të mbyllët me dy xhepa me pulla të kuqe dhe të zeza, një këmishë e kaltër me katrorë dhe me mbërthyes me zingjir, mëngët, jaka dhe xhepat e së cilës janë teget, dy

palë xhinsa teksas të fëmijëve «LEVIS», një këmishë fëmijësh e kuqërreme, një këmishë e zezë me kutia e madhësisë 56, çorapë të zeza me vija të kuqërreme-të gjelbëra, fanellë pambuku me vija të kaltra e të tërthorta me mëngë të gjelbëra dhe të verdha, çorapë perlon të kaltra me me shputë dhe gishtrinj të bardhë, sapun, pjesa e poshtme e veshjeve sportive (trenerkë) nga sintetika, me ngjyrë të zezë, me madhësi XXL, qëndisur me shkronja të bardha «SOCCER», 8 pako cigare «MONTE CARLO» dhe një copë llastik.

Trupi rreth qafe kishte të vendosur një hajmali. Në çantën prej lëkure për femra me mbërthyes metalik të përmendur më sipër janë gjetur një faculetë e bardhë e qëndisur, çorapë deri në gjunjë, një copë e kreoni, tre hapa «paracetamol», libreza shëndetësore (formulari i vjetër) dhe 42 fotografi me ngjyra-trupi «BA-186;

Një zingjir ari me shenjën në formë kryqi me anë të njejtë-trupi 2BA-219;

Një xhaketë e zezë lëkure me astar sintetik me etiketën «COBRA TEKS», e madhësisë 58 me mbërthyes zingjiri dhe me jakë të dyfishtë prej lëkure, një palë xhinsa «LECIS

501», të madhësisë 27-38, me rrip lëkure ngjyrë gështenje e qelë me katramëz metalike, një xhemper i punuar me makinë me prerje ovale me vija zhakar ngjyrë të murrme, një këmishë me vija ngjyrë vjollce dhe të kaltra për së gjati, brekë të gjata të bardha dhe slip-brekë të gjelbra, fanellë e bardhë me mangë të shkurtra me 5 pulla ngjyrë trëndafili dhe një çorapë ngjyrë të kaltër-trëndafili- trupi 2B-190;

Mbeturinat e setrës teget nga zherseji, këmisha ngjyrë me vija të kaltra, trëndafili dhe kuqërremë dhe mbeturinat e duksit ngjyrë vjollce-trupi 2BA-196;
një xhemper SMB në etiketën e të cilit shkruante "MILITARY EQUIPMENT" - trupi 2BA-197;

Një xhaketë ngjyrë gështenje me dy rrath që shërbenin për mbërthim, këmisha ngjyrë gështenje nga shtofi me katrorë të verdhë me pulla me ngjyrë të njejtë, xhemper i zi me jakë dhe tri pulla në pjesën e sipërme, mbeturinat e fanellës së bardhë me lara ngjyrë tirkizi dhe vjollce për së gjati dhe një tranzistor metalik me dy bateri - trupi 2BA-198;
Në pjesën e brendshme të dorës së djathtë kishte një tatuazh «JNA 8.7.1982», setër pepito me ngjyrë të përhimë me dy xhepa në pjesën e përparme me me pulla njëpalëshe me astar të zi dhe me etiketën «BULUT» nën xhepin e majtë të brendshëm, një duks ngjyrë tirkizi me prerje rrumbullake me shenjën «M» në pjesën e epërme të majtë, një duks me këllëf ngjyrë tirkizi dhe vijë të trashë në mes po të të njejtës ngjyrë, në të cilin ishte shkruar me shkronja të bardha «ENERGY», pjesa e poshtme e veshjeve sportive «ADIDAS» ngjyrë kaltër, dy palë brekë të gjata të përhimë, një çorapë e gjelbër dhe një këpucë e zezë e cekët me maje prej plumbi dhe me shollë gome me vija brinjore, një orë me rrip metalik, shkrepëz plastike ngjyrë të verdhë, çibuk, kuletë lëkure me dy bankënota prej nga 50 dinarë dhe një vizit-kartë. Që të gjitha këto sende janë gjetur në xhepin e setrës – trupi 2BA-199;

Një xhaketë e zezë prej lëkure me mbërthyes zingjiri dhe astar me 4 xhepa(2 dy për së gjati dhe dy tërthorazi) në pjesën e përparme. Në jakë ishte etiketa e qëndisur ngjyrë të verdhë-gjelbër, xhinsa të zi prej pëlhere të modelit «LEVIS 501», brekë të gjata të gjelbra me mbërthyes zingjiri plastik dhe me xhep pas, fanellë e zezë me mëngë të shkurtra me jakë në formë «V» me skaje të kthyer ngjyrë bardh-kuq, fanellë treger me vija të tërthorta ngjyrë vjollce-të bardhë, slip-brekë të gjelbra me vijë të bardhë, xhemper i zi me jakë rollkë u punuar me makinë, çorapë të përhimë në të cilat janë qëndisur fjalët «789 BOSTON COLLECTION» dhe këpucë lëkure të thella në gjuhëzën e të cilave ishte shkruar «CAT», zingjir ari rreth qafe(i këputur), shkrepëz plastike, vizit-kartë, pako me cigare «MONTE CARLO» - trupi 2BA-200;

57. xhemper ngjyrë të kuqe në të mbyllët punim dore, xhaketë e zezë lëkure dhe brekë të gjata të kuqërreme – trupi 2BA-201;

Slip-brekë të bardha me lule të kaltra me skaje të kthyer me llastik, xhinsa të kaltër të çelë «GAS» me rrip lëkure dhe katramëz të madhe metalike në të cilën janë vënë në mënyrë relievore shenjat e horoskopit, fanellë me vija të zeza të holla dhe me vija të drejta të kuqërreme – trupi 2BA-202;

Një qyrk me ngjyrë të kuqërreme, me astar prej gëzofi sintetik ngjyrë të kuqërreme, veshje sportive prej pambuku ngjyrë tirkizi, një palë çorapë të zeza, një çizme gome ngjyrë të gjelbër, një llambë me bateri, një pako «MALBORO», çibuk, disa gozhda të mëdha të ndryshkura, një foli me «analgina»-trupi 2BA-203;

Një jelek leshtë me ngjyrë të kuqërreme punim dore, opinga gome me rrip, çorapë leshtë ngjyrë të kuqërreme, një xhaketë me astar të bardhë, një këmishë e trashë nga shtofi dhe një këmishë pambuku meshkujsh - trupi 2BA-205;

Kartëmonedhë prej 1000 DM - në trupin 2BA-211;

Pasaporti i kuq në të mbyllët me shenjën SFRJ, me të dhëna të palexueshe, me fotografi të qartë, kuletë me kartëmonedhën prej 100DM-trupi 2BA-212;

Xhaketë kadife, ngjyrë të kuqërreme me astar të zi dhe me mbërthyes zingjir ne mes. Në astar nën jakë ka një etiketë me fjalët «THE BRAND OF QUALITY» dhe në mes me shkronja të mëdha «FORCE». Pjesa e poshtme e veshjeve sportive ngjyrë të zezë me dy vija të trasha dhe dy të holla për së gjati me dy xhepa anësorë me mbkthyes zingjiri dhe me mbishkrim në këndin e majtë të epërm «ADIDAS», xhinsa të zi prej shtofi punim fabrike me xhepa të vëna në mënyrë të tërthortë, me mbërthyes zingjir me dy pulla, me një etiketë me bazë të ndritshme, në të cilën ishte e shkruar me shkronja të kuqe «BUGLEBOY», duks me mëngë të gjata e jakë me tri pulla të përhimë me xhepin e përparëm të qepur, në të cilin ishte e shkruar «VIRSTIP», rollkë e mbyllët, brekë të gjata ngjyrë të kuqërreme si dhe nënkmisha me mëngë të gjata dhe çorapë të gjelbër-trupi 2BA-215;

Xhinsa teksas të kaltër, xhaketë ngjyrë ulliri-e përhimët nga shtofi i plotë me pambuk pëmbrenda dhe me astar me katrorë të kuq, me emblemë të zezë në pjesën e përparme të majtë, në të cilën është thurur një vijë e bardhë e paqartë, rollkë e kuqërreme në të cilën është thurur shenja «NIKE», fanellë pa mëngë ngjyrë të kuqërreme në të cilën ishte qëndisur me shkronja ngjyrë trëndafili-kaltër-verdhë «ESPRIT», ndërsa nën te «FREE TIME WEAR ORIGINAL DESIGN» - trupi 2BA-216;

Një këmishë më e plotë me jakë dhe pulla të verdha me vija të tërthorta të kuqe, të gjelbra dhe të kaltra me mbërthesë njëpalëshe në pjesën e përparme dhe me etiketën në të cilën ishte e shkruar «MARIOS», pantollona shtofi ngjyrë vjollce e mbyllët i punuar me makinë me rrip të zi e të trashë me dy gjilpëra dhe dy vrima, duks i kuqërremë me grukë rrumbullake me një pjesë të ngjitur në mes në të cilën është e shkruar «TEAM», pjesa e poshtme e veshjeve të zeza sportive me vija të tërthorta të bardha dhe të kaltra, fanellë me mëngë të shkurtra me mbishkrimin «OLIMPIA 2000» me rrathët olimpikë, brekë të shkurtra (shorce) frotiri të zeza, një këpucë e cekët e djathtë e zezë me lidhëse me shollë gome me vija brinjore në të cilën është e shkruar «ANTISTATICH HENKE nr. 42», një krahër plastike – trupi 2BA-217;

Xhinsa teksas të kaltër me rrip të vjetër dhe katramëz metalike, jelek i kuqërrem i punuar me makinë, duks i larëm me jakë me dy pulla dhe lara të tërthorta ngjyrë bardh-kaltër-gjelbër dhe teget, me etiketë të zezë në të cilën ishte e shkruar «JULEPS». Slip-brekë të larme zi-kuqërremë, brekë të gjata të bardha, fanellë e përhimë me mëngë të shkurtra me lara të zeza të zhdrejta me shkronja të kaltra dhe portokalli «THIS IS WHAT WE WERE LOOKING 4!» - trupi 2 BA-218;

Një xhaketë lëkure ngjyrë gështenje me skaje prej tjerri, me mbërthyes zingjiri, me jakë dhe xhepa të qepur me kapak dhe me etiketën «TRADITON-FULLSTOP COLLECTION ORIGINAL CLOTHING MANUFACTURES L», duks me mëngë të gjata me prerje në formë të shkronjës «V» dhe me etiketën «CAT», pjesa e poshtme e veshjeve sportive ngjyrë teget me vija të bardha anësore për së gjati me shenjën «NIKE», brekë të gjata të bardha, mprehëse lapsash ngjyrë gështenje, një shishe viski «JOHNNY WALKER RED LABEL», një medalje, dy zingjirë ari rreth qafe me një çelës metalik (vegël) të madhësisë 8/10. – trupi 2BA-219;

Pantallona të zi prej shtofi me rrip të zi dhe katramëz të zezë, bluzë e kuqërreme me prerje ovale dhe me mëngë të gjata, xhemper i gjelbër i punuar me makinë me prerje rrumbullake në cilin janë qëndisur gjuetari me pushkë dhe zagar, në 1/3 e pjesës së poshtme të të cilit vërehen lara të tërthorta me ngjyrë të verdhë, kaltër, gështenje, brekë të gjata të gjelbra, një këmishë nga viskoza me bazë të bardhë me lara të gjelbra dhe teget, jelek i kuqërremë punim dore, një xhaketë e zezë lëkure mëngët e së cilës në krih janë të ngjitura me mbërthyes zingji (patent) dhe me astar mëndafshi me katrorë të kuqërremë dhe çorapë të verdha meshkujsh, tabakerë e lëmuar nga metali i përhimë me shkronjat «JOB», regjistër-blok xhepi telefonash ngjyrë gështenje dhe një orë metalike

me rrip të zi me shifra arabe. Në pantollona janë gjetur një qese me duhan dhe letra për mbështjellje të duhanit, foli të ilaçit «bensendin» me pesë hapa – trupi 2BA-220;

Letërnjoftimi në emër të Seit (Gjon) Hasanaj/Seyt (Gjon) Hasanaj, i lindur më 30.3.1954 në fshatin Mejë, KK Gjakovë, JMBG 3003954940004, lnj.nr. 115483 i lëshuar më 9.1.1992, afati i vlefshmërisë 10 vjet, një orë me ngjyrë të zezë me rrip plastike – trupi 2BA-221;

Një xhaketë e shkurtër lëkure me mbërthyes zingjiror dhe me jakë, me astar të zi në anën e brendëshme të majtë të së cilës ka një xhep, një xhaketë e zezë me vija të kuqe në të mbyllët dhe me larë karakteristike bardh-gjelbër në anën e majtë të përparme, një jelek i kuq me tegela katrorë me dy xhepa në pjesën e përparme me kopsa me nitne në etiketën e të cilit është e shkruar “ORIGINAL BIG STARS CLOTHES –PREFERED FOR LONG WEAR”, xhemper i punuar me makinë ngjyrë gështenje me vija relieve përsë gjati me grykë rrumbullake, xhinsa të zi “LEVIS 501” të madhësisë W30-L36 me rrip të trashë në brez, pjesa e poshtme e veshjes sportive teget me dy shirita të bardhë dhe një të kaltër në anën e majtë të përparme të së cilës është e shkruar “FREEDOM SPORT”, pjesa e poshtme e veshjes sportive ngjyrë të përhimë me shirita bardh-kaltër dhe kuq e arnuar me arnë ngjyrë gështenje, çizme gome të gjelbra. nr .44 - trupi 2BA-227;

Hamajli - trupi 2BA-228;

Një krahër plastik ngjyrë roze, dy kartëmonedha prej 20 DM, orë me akrepa ngjyrë të verdhë dhe me akrepin e sekondave ngjyrë të kuqe dhe një qese me duhan «Tarabosh», në të cilën gjendeshin një palë çorapë rezervë-trupi 2BA-231;

Letërnjoftimi në emër të **Krist (Ibrahim) Sokoli**, i lindur më 16.10.1969 në Radonjiq, KK Gjakovë, JMB 1610969940023, vendbanimi - fshati Jahoc, KK Gjakovë, i lëshuar më 11.5.1998, nr. letërnjoftimit 188334, xhaketë e zezë lëkure me dy mbërthyes zingjiri dhe dy xhepa rezervë në pjesën e përparme me astar të kaltër dhe të kuqërremë, xhinsa të zi të markës «GAS» me rrip të gjërë me dy gjilpëra në katramëz të madhe metalike me dy vrima, çorapë të kaltra, çorapë të përhimë me larë të kuqe dhe këpucë të zeza të cekëta me lidhëse me shollë të trashë gome

«ABS nr. 41». Në xhepin e majtë të brendshëm të xhaketës janë gjetur një çelës me rreth, kuletë lëkure ngjyrë të përhimë, në të cilën gjendeshin dinarë metalikë dhe letërnjoftimi-trupi 2BA-225;

Pjesa e poshtme e veshjeve sportive sintetike, në anën e përparme me pjesë të rrjetore mbi bazën e kaltër dhe me shkronja të drejta me shenjën «NIKE», brekë të gjata frotiri ngjyrë teget, një pjesë e xhaketës së zezë, duks me mëngë të gjata ngjyrë përhimë e mbyllët me jakë në të cilën janë dy vija të zeza me tri pulla dhe me etiketën në të cilën shkruan «DIEGO COMPANY nr.2», një pjesë e këpucës së majtë, e zezë me shollë të trashë ngjyrë gështenje e çelë me lidhëse –trupi 2BA-233;

Pantallona të zi kadifeje me vija me rrip lëkure të të njejtës ngjyrë dhe me katramëz të madhe kënddrejtë, brekë të gjata ngjyrë ulliri-përhimë, një çorapë me lule të bardha të qëndisura, fanellë e hollë me mëngë të gjata dhe me prerje-grukë «V» rreth qafe, e bardhë me vija të kaltra dhe me një xhep në pjesën e epërme të majtë, një xhemper i kuqërremë i punuar me makinë me gjysëmrollkë me mbërthyes zingjiri dhe me etiketën «VA BENE», xhaketë e zezë lëkure me mbërthyes zingjiri me jakë dhe xhepa të gjërë me kapakë, nitne me mbyrthyes përsë gjati, kurse në etiketën e zezë është e shkruar me shkronja të kuqe: «SUCCEDEIR», e në xhepin e xhaketës është gjetur në pako «ranital» dhe një kuti e zhitave «SILVER» - trupi 2BA-234;

Një zingjir ari paksa i gjatë me dy lidhëse, njëra e mbërthyer, kurse tjetra në formë patentë në të cilën është e vënë figura e Skenderbeut dhe një orë kënddrejtë nga metali i përhimë. Pranë trupit është gjetur një kuti duhani – trupi 2BA-235;

Xhemper i punuar me makinë me vijë ngjyrë zi-kuqërremë e mbyllët-përhimë-gjelbër në jakën rreth qafe, këmishë e hollë nga viskoza me vijë të verdhë, të përhimë dhe të gjelbër, dy palë brekë të gjata frotiri të përhimë, fanellë e bardhë me mëngë të shkurtra në të cilën është e vizatuar figura e gjellëbërësit dhe shporeti me tekstin «NEUEROFFNUNG KUCHE 1999, HOTEL zum STORCHEN», xhaketë e zezë teksas me nitne në të cilën gjenden dy etiketa «FOSTER» dhe «INTERNATIONAL JEANS», xhinsa të zi teksas me etiketë të gjelbër në të cilën nuk dallohen shkronjat, xhaketë e zezë prej lëkure me zip metalik, nën jakë gjendet etiketa me mbishkrimin «HAPPY LIFE2, e madhësisë XL, hajmalia ngjyrë vjollce – trupi 2BA-238;

Një xhaketë me jakë në xhepin e majtë të së cilës është e shkruar shenja 2CITSANINI made in ITALY», një setër shtofi ngjyrë gështenje në pjesën e brendshme të së cilës gjendet etiketa me mbishkrimin «WASTON» dhe shenja «GARANI», pantallona shtofi me dy xhepa tërthorazi dhe me rrip ngjyrë gështenje rreth brezi, brekë të gjata pambuku ngjyrë të zezë, xhemper i punuar me makinë me mëngë të gjata me vija për së gjati ngjyrë vjollce në të mbyllët dhe me etiketën në të cilën është e shruar «CARSTERI made in ITALY», çorapë të leshta me lidhëse të punuara me dorë, fanellë me mëngë të shkurtra, çizme të zeza gome gjysëm të thella me shollë me vija brinjore nr.43, një orë dore e rrumbullakët me akrepa të hollë dhe një kuti xhileta të rrojës –trupi 2BA-239;

Letërnjoftimi dhe patent shoferi në emër të **Gani (Imer) Smajli**, JMBG

2508958940026, i lindur më 25.08.1958, në Nivokaz, KK Gjakovë, numri i i letërnjoftimit 127494, i lëshuar në fshatin Nivokaz, KK Gjakovë, më 3.11.1994. Janë gjetur edhe çizmet ngjyrë teget me shollë të verdhë, në pjesën e sipërme të çizmës shkruante «VIKING», mbeturinat e xhinsave teksas të djegura, në pjesën e belit gjendet rripi me katramëz metalike ngjyrë të përhimë, mbeturinat e duksit të djegur me vija të bardhë horizontale, mbeturinat e këmishës së bardhë, mbeturinat e duksit ngjyrë të kuqërreme, çorapë perlloni të përhimë, çorapë të leshta me lidhëse punim dore, mbeturinat e jelekut të djegur punim dore, pjesë të pasqyrës së thyer, prerëse të thonjve, fysht i lapsit kimikë, kuletë, në të cilën ishin letërnjoftimi, patent shoferi dhe kartëmonedha prej 1\$ dhe 20\$, kraher, shkrepëz dhe librezë anëtarësimi në kooperativën banesore-Gjakovë-trupi 2BA-240;

Dy vërtetime në pjesën anësore të xhaketës nga lëkura. Vërtetimi i parë është lëshuar më 04.01.1999 nga ana e Drejtorisë Republikane të të Hyrave Publike, seksioni për përcaktimin e të hyrave publike- Gjakovë nr.437.1/94 Gjakovë. Teksti i deklaratës « Në bazë të nenit 161 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative (G. Zyrtare, nr.33/97) dhe evidencës e cila mbahet në lidhje me pagimin e të hyrave publike – Shërbimi i të Hyrave Publike në Gjakovë i lëshon vërtetimin **Krasniqi (Qun) Bib** nga Gjakova, rruga e Korenicës, në lidhje me pagimin e borxheve të veta sipas rregullave të parapara për tremuujorin e katërt të vitit 1999. Vula-Republika e Serbisë, Drejtoria Republikane e të Hyrave Publike Beograd». Në vërtetimin e dytë është i shënuar po ky tekst. Në llërën e djathtë vërehet tatuazhi në formë kryqi – trupi 2BA-241;

Pantollona të kaltër nga shtofi me rrip me të njejtën ngjyrë, jelek ngjyrë të kuqërremë me relief punim dore me jakë «V», brekë të gjata ngjyrë të përhimë, nënkëmishë e bardhë me mëngë të gjata, fanellë e bardhë atletke, xhemper ngjyrë vjollce-përhimë punim makine me jakë të rrumbullakët, me etiketën «AIRPORT», këmishë e bardhë me mëngë të gjata me vija për së gjati ngjyrë të kaltër e madhësisë «37-38», çorapë ngjyrë të mbyllët, kupucë të cekëta (të tipit brodarica) ngjyrë të zezë me lidhëse me shollë gome ku shkruan «RUGGED» të madhësisë 9,5- trupi 2BA-242;

Brekë të gjata të trasha ngjyrë të përhimë të arnuara ndërmjet këmbëve, brekë të gjata ngjyrë gështenje të punuara me makinë, jelek i kaltër i thurur me dorë, nënkëmishë me mëngë të gjata me jakë rrumbullake, këmishë me mëngë të shkurtra me pulla me një

xhep të qepur në pjesën e epërme të majtë ngjyrë kaltër-përhimë, pjesa e poshtme e pizhamës me vija të kaltra për së gjati, xhemper i zi me romboide ngjyrë vjollce dhe të bardhë në formë «V» me pulla, i punuar me makinë që ka etiketën «EKSPRESION M made in USA», setër e leshtë e kuqërreme me shlic në anën e pasme dhe me xhepa të pjerrët me kapakë, pantollona të kuqërremë me xhepa të pjerrët dhe rrip lëkure ngjyrë të zezë, çorapë të zeza me lara në formë të luleve me katrorë të gjelbër, një palë çorapë të gjelbra nga frotiri – trupi 2BA-243

Pantollona ngjyrë të përhimë me rrip të zi nga lëkura me katramëz metalike dhe dy gjilpëra, brekë të gjata ngjyrë të përhimë, jelek kadifeje ngjyrë gështenje me mbërthyes zingjiri me gëzof artificial, si dhe dy xhepa anash-etiketa e përbërjes është shkruar në gjuhën gjermane të madhësisë «L», pjesa e sipërme e veshjeve sportive-trenerkë ngjyrë të kaltër-teget me mbërthyes zingjiri dhe mbishkrimin në mëngën e djathtë «CRAIZY», jelek i kaltër punim dore me jakë katrore, duks i kuqërremë me dy pulla të mëdha me mbishkrimin «LEE COOPER», pantollona të shkurtra ngjyrë të kaltër me pullë të bardhë dhe mbërthyes zingjiri, këmishë me mëngë të gjata me pulla dhe dy xhepa të qepur me kapakë, ndërkaq në etiketë shkruan «CUSTON CLUB» të madhësisë «M», çorapë

frotiri ngjyrë të mbyllët, një shputë çorape ngjyrë portokalli në të kaltër e punuar me dorë, në xhepin e pantollonave janë gjetur një kuti duhani, një palë çorapë rezervë ngjyrë gështenje me vijë të bardhë dhe një pjesë gazete - trupi 2BA- 244;

Një zingjirë ari rreth qafe, një orë dore nga metali i bardhë dhe një unazë (rreth), në xhepin e brendshëm të xhaketës janë gjetur një bateri nga plastika e kuqe, një krahër plastik ngjyrë gështenje, 4 çelësa, 2 thërmojca druri dhe 2 plastike, një letër e formatit A-4 me 2 thërmojca të tjera druri brenda saj dhe një faculetë e lagët. Në pjesën e brendëshme të unazës është gravuar: 10.6.62-1.8.62. - trupi 2BA-245

Letërnjoftimi në emër të **Brahim (Muharrem) Gaxheri**, i lindur më 1. 01.1961 në fshatin Junik KK Deçan, JMBG 0101961934991, nr. i letërnjoftimit 39321, i lëshuar më 9.7.1990, një orë, unazë(rreth), tri bateri prej 1,5 V, patrona për stilograf, një faculetë pëlhure me katrorë, gazetë e ripalosur dhe çantë (ceger) nga pëlhura, në të cilën është shtypur emblema në të cilën gjermanisht shkruan «“JOHANNTER UNFALL-HILFE” - trupi 2BA-246;

Një xhakete pëlhure ngjyrë të përhimë-kaltër me astar e mbërthyes zingjiri dhe me dy xhepa të pjerrët anash me mbërthyes zingjiri, një jelek i thurur me dorë me motive relieviore ngjyrë trëndafili, pjesa e poshtme e veshjeve sportive (trenerka) sintetike ngjyrë të zezë me mbërthyes zingjiri, në pjesën e përparme të veshjes gjendet mbishkrimi «NICA», një duks ngjyrë të çelë me mbishkrim të paqartë, fanellë e bardhë atletike, brekë të gjata standarde, fanellë e gjelbër me mëngë me mbishkrimin në pjesën e krahut « TRY TIPE», slip brekë të kaltra, pantollona kadifeje të plotë me kutia, ngjyrë të përhimë në të kaltër, një këpucë e djathtë e zezë me shollë gome – trupi 2BA- 245;

Një xhakete lëkure e zezë me astar me nitne dhe mbërthyes zingjiri, 2 xhepa të pjerrët, pantollona kadifeje të kaltër-përhimë, pantollona shtofi të mbyllët me rrip lëkure me katramëz metalike, slip brekë, këmishë me mbërthyes zingjiri me dezen me vija të bardha dhe të kaltëra për së gjati, 2 xhepa me kapakë, brekë të xhata, këmishë e zezë me vija të kaltëra në të gjelbër, duks i plotë ngjyrë të verdhë, në pjesën e përparme me mbishkrimin “MOJI. JE NAF NAF», çorapë të zeza sportive, fanellë atletike, nënkëmishë, xhakete shtofi e zezë me astar me dy xhepa të pjerrët anash, këpucë të cekëta lëkure për meshkuj me lidhëse, pjesa e epërme e këpucëve (te nyelli) nga shtofi - trupi 2BA-246;

Pasaportë dhe librezë shëndetësore të gjetura në xhepin e brendshëm të xhaketës. Pasaporta në emër të **Gjergj Prelaj** i lindur më 15.03.1970, adresa fshati Korenicë,

Gjakovë JMBG 1503970940036, nr.i pasaportës SB 345953, i vërtetuar 14.10.1996, i cili vlenë 5 vjetë. Libreza shëndetësore në emër të Kol Prelaj, i lindur më 1937 në fshatin Korenicë, e vërtetuar më 30.09.1995. Janë gjetur edhe një xhaketë e zezë shtofi i trashë me uçkurë rreth beli, me astar të larëm, xhinsa të kaltër me rrip lëkure dhe katramëz metalike, në anën e pasme me mbishkrimin «GAS INDUSTRY», xhemper i punuar me makinë ngjyrë të kaltër në të mbyllët, punim me motive relievi, me jakë të rrumbullakët, brekë të gjata pambuku, fanellë atletësh, orë dore metalike të rrumbullakët e markës «PATRICK AMAOUND» me akrep ngjyrë të verdhë, numra arabë, zingjirë ari me lidhëse në formë kryqi me figurën e Krishtit, prerëse e thonjëve, dy shkrepëza të larëme plastike, ilaçe në foli – 2BA -247;

Një xhaketë e gjatë shtofi me astar dhe mbërthyes zingjiri dhe nitne, xhemper me lara i punuar me makinë me dy xhepa me kapakë, setër ngjyrë gështenje me xhepa me kapakë, këmishë nga shtofi i plotë me vijë të trashë ngjyrë të verdhë-gjelbër, xhemper me relief i punuar me dorë, pjesa e poshtme e veshjeve sportive ngjyrë të zezë nga sintetika, në xhepat e së cilës janë gjetur dy palë çorapë, pantollona të zeza pëlhure, rrip lëkure me katramëz metalike, brekë të gjata me shlic, tri pulla në brez, ndërkaq në xhepat e setrës janë gjetur dy çibukë druri, dy lapsa plastike, një kuti zhileta, një makinë metalike rroje, tri pako sodo-bikarbonë, lëtrë për cigare, tri shkrepëza plastike, dy çelësa «ELZET», një çelës i rrumbullakët, në xhepin e pantollonave është gjetur një çantë-kuletë, ndërkaq në një pjesë të trastës nga skaji janë të vizatuar pjata e piruni dhe mbishkrimi «KIL HOLZ», trasta që mbahet rreth brezi me ngjyrë vjollce-të kaltër dhe të kuqe – trupi 2BA-248;

trupi ishte i veshur dhe i mbështjellë me najllon. Janë gjetur edhe pantollona nga shtofi i trashë ngjyrë hiri me vija, një jelek pëlhere ngjyrë gështenje e mbyllët, një këmishë me bazë të bardhë me vija të kaltra për së gjati, pjesa e poshtme e veshjeve sportive ngjyrë të kuqe të mbyllët nga pambuku, fanellë e bardhë pambuku atletësh, brekë të larjes me lara të ndryshme ku dominon ngjyra e kuqe, çorapë të shkurtra të kuqërreme - trupi BA-05-502T;

trupi ishte i veshur dhe i mbështjellë me najllon dhe me një batani të kuqërreme. Janë gjetur edhe një fustan i bardhë pëlhere me dantella në skajet e jakës, një fustan me bazë të kuqërremë me vija poashtu të kuqërreme për së gjati, astar i bardhë fustani prej pambuku, xhemper i përhimë, pjesë e veshjeve popullore nga shajaku i trashë i bardhë që mbahet rreth brezi, brekë të gjata të bardha pambuku, nënkëmishë e bardhë pambuku - trupi BA-05-506T;

letërnjoftimi i vendosur në një qese të veçantë PVC në emër të **Haxhi (Glemaj) Idrizi**, i lindur 10.10.1918 në Rakoc, Gjakovë, adresa Ivo Lola Ribar nr.?(nuk mund të lexohej), Pejë, JMBG 1010918934951, nr. i Inj. 138999. Trupi ishte i veshur dhe i mbështjellë me najllon. Janë gjetur një palë pantollona me fallta të imëta ngjyrë hiri, një xhemper i punuar me dorë me bazë të kaltër dhe vija të gjelbra të çela, një xhemper me pulla i kuqërremë, nënkëmishë e bardhë pambuku, një këpucë e murrme e thellë numër 43 nga lëkura e kthyer dhe me shollë gome dhe kartëmonedhat prej 2x100DM e 1x50DM - trupi BA-05-504T;

një setër e përhimë e mbyllët, fanellë e bardhë pambuku me mëngë të shkurtra, pantallona me fallta të imëta ngjyrë gështenje dhe brekë të leshta të gjata - trupi BA-05-503T;

trupi ishte i veshur dhe i mbështjellë me najllon dhe me një batani ngjyrë gështenje. Janë gjetur edhe pjesa e poshtme e veshjeve sportive ngjyrë gjelbër nga sintetika, pantallona nga shtofi ngjyrë gështenje me rrip lëkure ngjyrë gështenje në brez, brekë të kaltra të gjata pambuku, çorapë të shkurtra ngjyrë të çelë, një patikë e djathtë e markës »ADIDAS« model atletësh dhe me kombinim të pëlhurës mbyllët dhe të çelë me shollë të trashë me vija brinjore, një xhemper i përhimë me pulla dhe një nënkëmishë pambuku me mëngë të gjata - trupi BA-05-507T;

pantallona me fallta të imëta të kuqërreme, brekë të leshta ngjyrë gështenje të punuara me makinë, një setër e përhimë e mbyllët me astar të çelë dhe me etiketën »PKZ EXCLUSIVE«, një nënkëmishë e bardhë pambuku me mëngë të gjata dhe një këmishë e bardhë pambuku - trupi BA-05-508T;

trupi ishte i mbështjellë me najllon, mbeturinat e fanellës atletike, mbeturinat e një duksi me jakë me mbërthesë, mbeturinat e brekëve të gjata dhe mbeturinat e pantallonave – trupi BA-05-509T;

trupi ishte i veshur dhe i mbështjellë me najllon dhe me batani ngjyrë gështenje. Janë gjetur edhe pjesa e epërme e veshjeve sportive me bazë të kaltër dhe me vija bardhë-

verdh në mëngë, kurse në pjesën e gjirit të majtë gjendet mbishkrimi »FC FENERBACHE« - »ADIDAS«, pjesa e poshtme e veshjeve sportive me bazë të kaltër dhe me aplikacione bardh-verdh e markës »ADIDAS«, xhinsa nga teksasi i zi me rrip të zi lëkure në brez, nënkëmishë e bardhë pambuku, fanellë e bardhë atletike prej pambuku, brekë të bardha të gjata pambuku, një duks i kuqërremë jaka e të cilit mbërthehet me mbërthyes zingjiri, në gishtin e dorës së majtë është gjetur një unaz ari. Kjo unazë është gjetur me rastin e hapjes së thesit të kufomës dhe gjendej panë trupit - trupi BA-05-510T;

trupi ishte i veshur dhe i mbështjellë me najllon. Janë gjetur një brushalter, kombinezon i zi me bretela të holla, një çarçaf pëlhere me dantela në skaje, mbeturinat e çorapave të najllonit, një fustan i zi dhe një nënkëmishë e bardhë pambuku - trupi BA-05-511T;

pantallona të. Trash nga shtofi i përhimë, sbrekë të bardha të gjata nga pëlhura e vrashtë, mbeturinat e çorapës së leshtë me tlja - trupi BA-05-512T;

trupi ishte i veshur dhe i mbështjellë me najllon. Janë gjetur një këmishë me kutia të kaltra-kuqërreme, një jelek i leshtë i punuar me dorë, një xhemper me grykë-prerje të rrumbullakët rreth qafe i punuar me makinë ngjyrë gështenje e mbyllët, një nënkëmishë e bardhë pambuku me mëngë të gjata dhe një setër e gjelbër nga çoja e gjelbër - trupi BA-05-513T;

trupi ishte i veshur dhe i mbështjellë me najllon. Janë gjetur xhinsa teksasi të zi me një rrip të zi lëkure me nitne në brezin e xhinsave, një xhaketë dimri nga sintetika e gjelbër, pjesa e epërme e veshjeve sportive me bazë të të zezë me vija bardh-verdh të markës »ADIDAS«, një fanellë e bardhë atletike prej pambuku, jelek dimri i zi nga sintetika, një duks me jakë që mbërthehet me tri pulla ngjyrë kuqërremë, kurse në pjesën e pasme ka një aplikacion në formë mbishkrimi »ACTIVE LIFE – HIS«, një këmishë e kuqërreme nga kadifeja me vija të imëta me etiketën »LE TIGRE«, brekë të bardha të gjata pambuku, një çorapë e leshtë e punuar me dorë, një kapelë e zezë e punuar me makinë, në pjesën e përparme ka mbishkrimin »REEBOK«, një patikë e djathtë, modeli atletik me kombinim të lëkurës bardh-zi me shollë me vija brinjore e markës »ADIDAS«, rreth qafe është gjetur një zingjir ari me shenjën e varur në formë të shkronjës »M«, në nyellin e dorës së majtë është gjetur ora e dorës nga plastika, digjital, e zezë e markës »SHYE« - trupi BA-05-514T;

trupi ishte i veshur dhe i mbështjellë me najllon dhe me një batani të kuqërreme. Janë gjetur pantallona nga shtofi i trashë ngjyrë kuqërremë, brekë të kuqërreme të gjata frotiri, një xhaketë lekure dimri ngjyrë gështenje me gëzof artificial përbrenda, një jelek lekure ngjyrë gështenje, çorapë të leshta të punuara me dorë, një këmishë flaneli e kaltër, një këpucë e cekët e majtë me lidhëse ngjyrë gështenje - trupi BA-05-515T;

trupi ishte i veshur dhe i mbështjellë me najllon dhe me një batani të kuqërreme. Janë gjetur tespi të bardha në një qese të veçantë nga PVC dhe një orë xhepi metali marka e së cilës nuk mund të lexohej - trupi BA-05-516T;

5. Batajnica 07 [BA07]

5.1 Ekshumimi dhe autopsia e trupave: 04. nëntor deri 13. dhjetor 2002.

5.2 Ekipi i Institutit të Mjekësisë Ligjore nga Beogradi:

profesor dr. Branimir Aleksandrić, profesor dr. Slobodan Savić, dr. Dragan Ječmenica, dr. Đorđe Alempijević, dr. Snežana Pavlekić, profesor dr. Marija Đurić, dr. Danijela Đonić i Petar Ilinčić, teknik i kriminalistikës.

5.3 Ekipi i Komisionit Ndërkombëtar për persona të zhdukur (ICMP):

Xhon Sterenberg (Jon Sterenberg), arheolog, Hju Taler (Hugh Taller), antropolog forenzik, En Skofild (Ann Scofield) antropolog dhe arkeolog forenzik i Vladimir Gaćeša, vëzhgues ICMP-a.

5.4 Vëzhgues:

Marko Minić, Fondi për të Drejtën Humanitare.

5.5 Terreni:

Lokacioni gjendet në kuadër të qendrës policore-sportive, 300 metara larg Danubit rreth një kilometër në jug të rrugës Beograd-Batajnicë. Varreza gjendet prapa poligonit të çitjes të qendrës sportive, 2 metara në anën e majtë në drejtim të veriut nga lokacioni Batajnica 05. Sipërfaqja e përgjithshme e vendit është 10 x 3 metra. Të gjithë trupat, si dhe sendet dhe rrobat e gjetura janë ekspozuar në tunelin që gjendet në afërsi të qendrës policore-sportive «13 Maj».

5.6 Parametrat indentifikues:

nofulla e poshtme e thyer;

nofulla e poshtme e thyer.

5.7 Pjesë të ndryshme rrobash:

litari në fund të të cilit janë të lidhur një fanellë dhe çorapat.

5.8 Sende të ndryshme:

purtekë aluminiumi; gomë kamioni; një dërrasë; 6 purteka metalike; një thes najlloni me pjesë rrobash; derë metalike aeroplani dhe pjesë aeroplani¹⁵; pllaka të mëdha stiropori; sy xhami; çibukë; mbulesë (ciradë) kamionësh në të cilën shkruan TRANSJUG – RIJEKA - OOUR BEOGRAD; shenja e komunikacionit për kthim që gjendet në kamion; një anë e kamionit-frigorifer; një unazë ari; 5 orë dore në të cilat nuk mund të dallohej marka dhe një orë dore në të cilën dalloheshin të dhënat: marka “SEIKO”, data: 29, akrepat janë ndalur në ora 06,06, akrepi i sekondave është ndalur në numrin 19, numri serik: 073190; një pjesë gome e amortizatorit të kabinës së kamionit; një purtekë druri; tespi; unazë ari; dy dorëza gome (të grisura); një profil metalik në formë kutie; një plakë e hollë llamarine; një pjesë e plastikës së kuqe (pjesë e stop-dritës së automjetit); një unazë argjendi e gjërë; rrënjë bime; një kuletë; një thes i zbrazët kufomash; rrip metalik i orës së dorës; purtekë metalike kamioni; foli plastike me dokumente; një figurë e vogël xhami për zbukurim në formë të kaprollit; dy bimë të thara; kartelë telefoni mobil (SIM kartelë), MOBTEL; kartelë telefoni mobil (SIM kartelë), në shpinë të kartelës është i gravuar numri: 38101981161427-kartela e MOBTEL-t.

5.9 Parametrat identifikues, rrobat dhe sendet e gjetura në pjesët e trupit:

shputa e majtë në çizme – pjesa e trupit BA-07-085DT.

¹⁵ Vëzhguesi i FDH ka marrë informata nga pjesëtarët e SAJ se maketa e aeroplanit që gjendej në poligonin e çitjes është shfrytëzuar për eksperimente balistike.

5.10 Parametrat identifikues, rrobat dhe sendet e gjetura në trupa:¹⁶

Pantalona të përhimë të mbyllët nga shtofi i trashë, një rrip pëlhere i murrëm në brez i qepur me pe të gjelbër, një këmishë roze e çelë me vija diskrete të mbyllëta për së gjati, një xhemper ngjyrë gështenje me një larë të kaltërreme në një të tretën e poshtme të anës së përparme dhe në mëngë, slip brekë të bardha meshkujsh, një xhaketë ngjyrë hiri e mbyllët nga sintetika me aplikacione të kuqërreme të çela në një të tretën e epërme të anës së përparme – trupi BA-07-008T

një xhaketë nga pëlhura e zezë me astar të zi sintetika dhe me mbërthyes zingjiri metalik, xhinsa nga kadifeja e kuqërreme me rrip lëkure ngjyrë gështenje në brez, një këmishë nga flaneli i trashë me kutia të mëdha kaltër-zi, fanellë e bardhë atletike prej pambuku – trupi BA-07-011T;

pantallona të dezenit pepito ngjyrë hiri e mbyllët, një duks i kuqërremë i çelë ose i kaltërremë, xhemper ngjyrë gështenje me grykë-prerje të rrumbullakët rreth qafe, një palë çorapë të shkurtra teget – trupi BA-07- 014T;

xhaketë dimri nga skaji i zi, një duks me bazë të kuqërreme në pjesën e përparme të të cilit gjenden 5 aplikacione në formë të stemave të llojlojshme të kombinuara me vija të zeza vertikale, një duks i hollë i kaltërremë me grykë-prerje të rrumbullakët rreth qafe, mbeturinat e xhinsave të grisur, një palë këpucë të thella ngjyrë gështenje me shollë të trashë në të cilën shkruan “MENS SPORT” dhe një çorapë e shkurtër e kaltër – trupi BA-07-017T;

një këmishë nga flaneli i kaltër i trashë me vija të tërthorta ngjyrë të zezë-përhimë, xhinsa nga kadifeja e trashë e kuqërreme, pjesa e poshtme e veshjeve sportive nga sintetika, në na kofshën e majtë është mbishkrimi “REEBOK”, brekë-bokserica meshkujsh me bazë të kaltër me aplikacione të larme në formë të gjetheve, një këpucë e majtë e cekët snga lëkura e zezë, një rrip i zi lëkure, një palë çorapë të shkurtra ngjyrë gështenje – trupi BA-07-018T;

xhaketë dimri nga çoja e përhimë, një duks i kuqërremë, pantallona të kuqërremë nga kadifeja, mbeturinat e pjesës së poshtme të veshjeve sportive ngjyrë teget me tri vija të kaltërreme përgjatë këmbës – trupi - BA-07- 019T;

fanellë me mëngë të shkurtra ngjyrë hiri, në një të tretën e pjesës së përparme mbi vija gjendet mbishkrimi “USE REICLED AND BI DEGRADABLE MATERIJALS CLASSIC”, një duks me kapuç të përhimë, në pjesën e gjirit të majtë gjendet mbishkrimi “LEVIS”, një palë çorapë të leshta të punuara me dorë të përhimë me vija të katërreme, pjesa e poshtme e veshjeve sportive ngjyrë teget me tri vija përgjatë këmbës të markës “ADIDAS”, xhinsa nga teksasi i kaltërremë të markës “LEVIS 501”, madhësia 34-32, një palë këpucë të thella, modeli i cokullave sportive-alpiniste, brekë të larjes teget të markës “SPEEDO”- trupi BA-07-020T;

xhaketë dimri nga shtofi ngjyrë gështenje, setër dhe pantallona nga shtofi i zi, një xhemper me pulla me lara të zhdrejta ngjyrë gështenje dhe të kuqërreme, një këmishë me vija të holla kuq-bardh për së gjati, një nënkëmishë e bardhë pambuku me mëngë të gjata dhe pjesa e poshtme e veshjeve sportive të kaltra prej pambuku – trupi BA-07-021T;

pantallona nga shtofi ngjyrë gështenje, një këmishë e bardhë pambuku me mëngë të gjata, një xhemper i punuar me dorë, brekë të zeza të larjes, një çorapë e shkurtër ngjyrë hiri dhe një setër e kaltër me astar të kuqërremë – të gjetura në trupin BA-07-023T;

¹⁶ Të gjithë parametrat identifikues, rrobat dhe sendet janë shënuar me numrin e trupit në të cilin janë gjetur.

mbeturinat e xhinsave të kuqërremë, mbeturinat e duksit të kuqërremë, në anën e majtë të përparme ka mbishkrimin “LEVI STRAUSS”, mbeturinat e duksit të kaltër si dhe mbeturinat e fanellës së kaltër atletike – trupi BA-07-022T;

një duks me jakën që mbërthehet me zingjir metalik me bazë të kaltër me vija të përhimë të çela vertikale, brekë të gjata pambuku ngjyrë hiri, dhe një fanellë e bardhë pambuku atletike – trupi BA-07-024T;

pantallona nga shtofi i përhimë, pjesa e poshtme e veshjeve sportive ngjyrë teget me tri vija për së gjati të markës “ADIDAS”, një këmishë nga teksasi i zi e markës “LEVIS”, një duks me bazë të përhimë, kurse në pjesën e përparme gjendet aplikacioni në formë vizatimi të fluturës dhe mbishkrimi “WONDERLAND TRIANGLE”, një fanellë e kuqe pambuku atletësh, brekë-bokserica meshkujsh ngjyrë shiri, në këmbën e majtë gjendet një vijë e zezë, një çorapë e shkurtër e zezë ngjyrë hiri – trupi BA-07-026T;

një këmishë pëlhure e kuqërremë, në anën e mbrendshme të jakës gjendet etiketa “DORODO”, një xhemper i punuar me dorë, gjysma e poshtme e anës së përparme ngjyrë teget, gjysma e epërme e anës së përparme ngjyrë e kuqërremë, në pjesën e kuqërreme është thur mbishkrimi DEOMOKRACIA, një xhemper i hollë i kuqërremë i çelë, me jakë gjysëm rollkë, pjesa e poshtme e veshjeve të gjelbra sportive prej pambuku dhe një palë çorapë të shkurta të kuqërreme – trupi BA-07-028T;

xhinsa teksasi ngjyrë hirë të mbyllët, xhakëtë dimri e kuqërreme në të verdhë me mbërthyes metalik dhe me disa pulla ngjyrë portokalli, pjesa e epërme dhe e poshtme e pizhamës së përhimë me lara të gjelbra të zhdrejta, në xhepin e djathtë të xhakëtës është gjetur një lugë këpucësh – trupi BA-07-032T;

xhinsa teksas me një rrip të zi lëkure në brez, një xhemper i punuar me makinë me bazë të zezë dhe me lara të gjelbra-kaltra të zhdrejta, në anën e përparme është i arnuar me dorë në tri vende me pe ngjyrë gështenje, pjesa e poshtme e veshjeve sportive të kaltra, një këmishë me kutia nga flaneli i trashë ngjyrë kuq-gjelbër, brekë të larjes ngjyrë vjollce me vija të bardha një pjesën kërdrhokullave, një çorapë e shkurtër ngjyrë hiri, pranë trupit është gjetur ora plastike e dorës me bazë të bardhë dhe me akrepa të zinj e markës “SHARP” – trupi BA-07-034T;

një fustan i kuq i mbyllët me lastik në bel nga pëlhura e bardhë prej pambuku dhe mbeturinat e një faculete të bardhë – trupi BA-07-035T;

një këmishë e kuqërremë kadifeje me vija të imëta me katrorë vegjël të kuqërremë në formë të aplikacioneve, një duks i kuqërremë, një këmishë nga keperi i kuqërremë, brekë të bardha të gjata pambuku, xhakëtë dimri me aplikacione ngjyrë vjollce dhe të kuqërreme, xhinsa teksas me një rrip të zi lëkure në brez - trupi BA-07-036T;

një xhemper me lara kaltër-kuqërremë-zi i punuar me makinë, një këmishë nga keperi i zi, pjesa e poshtme e veshjeve sportive nga sintetika ngjyrë tirkizi - trupi BA-07-040T;

një xhemper me gërshetë në anën e përparme ngjyrë gjelbër e çelë, brekë të gjata dhe një pjesë e këmishës – trupi BA-07-037T;

një fustan i zi, nënkëmishë e bardhë pambuku, mbeturinat e jelekut të leshtë të punuar me dorë, jelek femrash i zi, brekë të bardha të gjata pambuku, pranë eshtrave të kokës është gjetur edhe një vath-rreth ari - trupi BA-07-045T;

një xhemper me pulla me bazë të zezë dhe me vija të kuqërreme, xhemper i kuqërremë me lule ngjyrë vjollce, brekë të leshta të zeza të punuara me makinë, nënkëmishë e bardhë pambuku, mbeturinat e jelekut të leshtë të punuar me dorë, në një qese të veçantë është gjetur një vath-rreth ari. Pranë trupit është gjetur një orë dore digjitale nga plastika e zezë – trupi BA-07-048T;

një jelek dimri nga sintetika e zezë, setër meshkujsh nga shtofi i zi me dy palë pulla, një xhemper i kuqërremë me pulla, një xhemper me ngjyrë të çelë me pulla, një këmishë

ngjyrë vjollce e çelët numër 43/44 me vija të mbyllëta për së gjati, një çorapë e bardhë sportive me 13 në kind – trupi BA-07-049T;

setër meshkujsh ngjyrë gështenje e çelë, pantallona ngjyrë e kuqërreme me rrip lëkure ngjyrë gështenje në brez, një këmishë me kutia të kaltra-përhime në të çelë, nënkëmishë e bardhë pambuku, brekë të gjata të përhime pambuku, jelek i punuar me dorë, xhemper i punuar me makinë i kuq i mbyllët dhe një çorapë e shkurtër e përhimë – trupi BA-07-052T;

pjesa e poshtme e veshjeve sportive prej pambuku ngjyrë teget, mbeturinat e këmishës me katrorë të kuq-kaltër, xhemper teget i punuar me dorë, pantallona nga kadifeja ngjyrë gështenje me rrip lëkure ngjyrë gështenje në brez, një çorapë e shkurtër ngjyrë e përhimë-kuqërremë, në një qese të veçantë nga PVC gjendet ora e dorës prej metali e markës “ZENIT” – është gjetur pranë trupit BA-07-053T;

pantallona nga shtofi i përhimë me rrip lëkure ngjyrë gështenje në brez, pjesa e poshtme e veshjeve të zeza sportive me një vijë të bardhë përgjatë këmbës, këmishë me mëngë të gjata me kutia të mëdha ngjyrë kaltër-gjelbër, një xhemper me pulla ngjyrë gështenje i punuar me dorë – trupi BA-07-058T;

mbeturinat e xhaketës nga skaji i zi, pjesa e poshtme e veshjeve të kaltra sportive me tri vija të bardha përgjatë këmbës e markës “ADIDAS”, slip brekë të bardha meshkujsh prej pambuku, një çorapë sportive e bardhë me vijë të kaltër dhe të kuqe në skaje, fanellë atletike e bardhë prej pambuku – trupi BA-07-059T;

xhinsa teksas me rrip të zi lëkure në brez, brekë të gjata të përhime prej pambuku, një çorapë e shkurtër e përhimë dhe një fanellë e bardhë pambuku - trupi BA-07-062T;

jelek i leshtë i gjelbër i punuar me dorë, xhemper me pulla i punuar me dorë, këmishë me kutia të kaltra-kuqërreme, pantallona nga shofi i përhimë, mbeturinat e jelekut të leshtë, brez i leshtë për mbrojtjen e veshkëve dhe brekë të bardha të gjata pambuku - trupi BA-07-065T;

pantallona nga shofi i përhimë, jelek i punuar me dorë, brekë të bardha të gjata pambuku, fanellë e bardhë atletike prej pambuku, këmishë e bardhë pambuku dhe brekë-bokserica të bardha meshkujsh – trupi BA-07-069T;

pantallona nga shtofi i përhimë në të kaltër me rrip lëkure ngjyrë gështenje në brez, xhemper ngjyrë gështenje, në anën e përparme me lara të kaltërreme, pjesa e poshtme e veshjeve sportive ngjyrë hiri e mbyllët, mbeturinat e këmishës së bardhë prej pambuku, xhaketë dimri ngjyrë oker, në anën e brendshme nën jakë ka etiketën dhe mbishkrimin “NEW ART JUMCO DESIGN”, xhaketa ka astar me kutia ngjyrë të kuqërreme - trupi BA-07-070T;

pantallona nga kadifeja e plotë ngjyrë gështenje, brekë të leshta të gjata me ngjyrë të zezë, fanellë e bardhë pambuku, një palë çorapë të shkurta ngjyrë të kaltër, slip brekë me bazë të bardhë dhe vija të kaltëra për së gjati - trupi BA-07-071T;

pjesa e poshtme e veshjeve sportive teget nga sintetika me astar ngjyrë vjollce, në kofshë gjendet mbishkrimi “CHICAGO BULLS” dhe emblema e qepur e këtij ekipi – koka e demit, xhemper i hollë teget i punuar me dorë, xhemper me prerje të rrumbullakët rreth qafe, një palë çorapa të shkurtra ngjyrë të përhime, slip brekë të bardha, fanellë e bardhë atletike nga pambuku, brekë të bardha të gjata nga pambuku - trupi BA-07-073T;

panollona të gjërë nga pëlhura ngjyrë gështenje me aplikacione të zeza (dimi-veshje kombëtare), xhemper me lara të përhimë - kuqërreme, nënkëmishë e bardhë me mëngë të shkurtra - trupi BA-07-076T;

pjesa e poshtme dhe e epërme e veshjeve sportive nga materiali sintetik me bazë teget dhe aplikacione të bardha e të kuqe të mbyllët, në kofshën e majtë gjendet emblema e firmës “ADIDAS” me tri vija për së gjati të bardha në këmbë dhe mëngë, duks i

kuqërremë me mbërthyes zingjiri metalik, brekë të bardha të gjata pambuku, pjesa e poshtme e veshjeve sportive me ngjyrë të kuqërreme, në pjesën e brendshme gjendet etiketa e markës “ADIDAS”, rollkë e përhimë çelë, një palë çorapa deri në gjunj me ngjyrë të përhimë, një palë çorapa të shkurtra ngjyrë të përhimë të mbyllur, slip brekë me bazë të bardhë me vija për së gjati ngjyrë të mbyllët - trupi BA-07-088T;

pjesa e epërme e veshjeve sportive ngjyrë teget të markës “NIKE”, pantallona nga shtofi i zi, këmishë nga teksasi i zi, një duks me katrorë të përhimë me jakë me mbërthyes zingjiri metalik, në pjesën e majtë gjendet mbishkrimi “FIGARO”, një duks ngjyrë të kuqërremë të çelë të markës “FILA”, fanellë e bardhë atletike nga pambuku, brekë të gjata nga frotiri i bardhë, slip brekë të bardha nga pambuku - trupi BA-07-090T;

duks ngjyrë të përhimë të çelë me jakë që mbërthehet me tri pulla, në pjesën e përparme gjendet aplikacioni në formë të vizatimit të tre lojtarëve të ragbit, në pjesën e poshtme të anës së përparme gjendet mbishkrimi “INTERESTING TASFEB YAMAZOH”, një blushalter tentene, fanellë me bretela të holla, trupi ishte i mbështjellë në jamboli të kuqe - trupi BA-07-091T;

pasaporta e RSFJ, letërnjoftimi, biletë e udhëtimit të punëtorëve të NHT janë gjetur në rrobat e grisura. Pasaporta ishte në emër të **Rrahim Barbatovci**, i lindur më 06.07.1938 në fshatin Miradi, Fushë Kosovë, adresa Miradi e Poshtme, Fushë Kosovë, JMBG 060793811012, nr. i pasaportës 560258. Letërnjoftimi – të dhënat janë identike me të dhënat e pasaportës, përveç emrit të njërit prind - Xheladin, nr.i Inj. 16939. Leja e udhëtimit në hekurudhat jugosllave për punëtorët e NHT, emri - Barbatovci, i punësuar në: NHT Beograd – njësia punuese Fushë Kosovë. Pantollona nga pëlatura e zezë me rrip të ngushtë lëkure në brez, këmishë me ngjyrë të kaltër të çelë me mëngë të gjata, xhemper me ngjyrë të përhimë të mbyllët me vija horizontale, brekë të gjata pambuku ngjyrë të përhimë, çorapë të zeza, slip brekë pambuku, një palë këpucë të thella e të zeza me lidhëse, në shollë shkruan “EUROSTIL”, një digitron nga plastika e zezë që punon me energji solare, dy lapsa kimikë me ngjyrë teget e të bardhë, 3 vizit-karta dhe vizit-karta në emër të Vladimir Milenković, solist vokal - fizarmonicist – dasma dhe përcjellja. II vizit- kartë - firma KEUROKOHA REISEN Prishtinë 38000, Qyteza Pejton – telefoni dhe faksi: 038/24-459. III vizit-kartë firma EUROPALCHE REISE AGENTURE, në emër të Ruzhdi Durmishit – Hamburg - trupi BA-07-098T;

një setër mashkulli ngjyrë të përhimë e mbyllët me vija diskrete të çela për së gjati, pantollona nga shtofi i përhimë, brekë të përhimë të gjata pambuku , këmishë me katrorë nga flaneli me ngjyrë të kaltër e të kuqërremë, xhemper i përhimë i punuar me makinë, nënkishë e kaltër pambuku me mëngë të gjata, një palë çorapë të shkurtra ngjyrë të përhimë, pantollona nga shtofi i përhimë me rrip lëkure ngjyrë gështenje në brez - trupi BA-07-093T;

këmishë me katrorë të përhimë - kaltër, brekë të gjelbra të gjata nga pambuku, pantallona nga kadifeja e plotë me ngjyrë të përhimë me rrip të zi lëkure në brez, fanellë e kaltër pambuku me mëngë të gjata, një çorapë e shkurtër me bazë ngjyrë gështenje dhe lara të kuqërreme - trupi BA-07-097T;

një duks i përhimë me aplikacione të verdha në anën e përparme, blushalter i bardhë me tentene, një çorapë e leshtë e punuar me dorë, çarçaf pëlature me të cilin ishte i mbështjellë trupi - trupi BA-07-099T;

xhaketë dimri me ngjyrë të kuqërreme me astar nga gëzofi artificial, nënkishë e bardhë pambuku, një pjesë e brekëve të gjata pambuku, këmishë e bardhë pambuku, një xhemper me pulla me ngjyrë të përhimë, mbeturinat e pantallonave - trupi BA-07-100T;

xhaketë dimri ngjyrë të gjelbër me astar ngjyrë vjollce, pantallona nga kadifeja ngjyrë gështenje, brekë të bardha të gjata nga pambuku, këmishë me ngjyrë të çelë me lara të përhimë, fanellë e bardhë pambuku me mëngë të gjata, xhemper i kaltër me pulla i

punuar me dorë, dy palë çorapë të shkurtra ngjyrë të përhimë - trupi BA-07-103T/ BA-07-101DT;

pantallona nga shtofi i përhimë me rrip të zi lëkure në brez, brekë të gjata pambuku me ngjyrë të përhimë, këmishë e bardhë pambuku me vija të zeza diskrete për së gjati, brekë të bardha të gjata nga pambuku, pjesa e poshtme e veshjeve sportive nga materiali sintetik me aplikacione të bardha dhe të kuqe të mbyllët në pjesën e epërme të markës “ADIDAS” - trupi BA-07-104T;

mbeturinat e pantallonave me ngjyrë të përhimë, pjesa e poshtme e veshjeve sportive të gjelbra, në kofshën e majtë gjendet mbishkrimi “REEBOK”, dy palë çorapë të shkurtra ngjyrë të përhimë - trupi BA-07-106T;

jelek dimri nga sintetika ngjyrë teget i markës “REEBOK”, këmishë e përhimë me katrorë të mëdhenj, një setër nga shtofi i plotë , pantallona nga shtofi i zi me rrip ngjyrë gështenje në brez, pantallona nga materiali i plotë i përhimë, brekë të përhimë të gjata pambuku, nënkishë e bardhë pambuku me mëngë të gjata, xhemper ngjyrë të kaltër, në anën e përparme me lara horizontale, xhemper me bazë të kuqërremë dhe me lara të kuqe të mbyllët dhe të zeza - trupi BA-07-109T;

xhemper i përhimë me jakë të rrumbullakët rreth qafe, fanellë pambuku me mëngë të shkurta, xhakëtë e gjelbër dimri me astar nga gëzofi artificial i kuqërremë, në pjesën e brendshme të jakës gjendet etiketa “SOOTTR”, duks ngjyrë të përhimë të çelë me një vijë të gjelbër, brekë të bardha pambuku, slip brekë të bardha - trupi BA-07-111T;

pantallona të gjërë (kule) me bazë të kuqërreme me vija të zeza, brekë femrash nga pambuku, xhemper me ngjyrë gështenje me pulla i punuar me dorë, fanellë me bretella të holla, pantallona të gjërë (kule) të përhimë, një palë çorapa të shkurtër me ngjyrë të kuqe, një palë çorapë të zeza të shkurtra, një palë çorapë të zeza të shkurtra, në dorën e majtë është gjetur një orë dore femrash me rrip që është i punuar me pllakëza të holla metali, e markës “AIVA”, ora është e praruar me ari perrreth - trupi BA-07-112T;

këmishë pambuku me ngjyrë të kuqe të mbyllët me mëngë të gjata, slip brekë të bardha femrash, pantallona të gjëra (kule) me bazë ngjyrë gështenje me lara të zeza, fanellë me bretella të holla, jelek i punuar me dorë, nënkishë me mëngë të gjata, në veshin e majtë është gjetur një vath ari në formë të rrethit me pllakëz të hollë - trupi BA-07-116T;

pjesa e epërme e pizhamave me bazë të kuqërreme me aplikacione të zeza në formë rombesh , duks me bazë të kuqërremë me rreth të gjelbër rreth jakës dhe mëngëve , fanellë pa mëngë me bazë ngjyrë të përhimë dhe me një vijë të trashë të kaltër të pjerrët në pjesën e përparme, duks ngjyrë të kuqe të mbyllët, brekë të bardha meshkujsh nga pambuku, brekë të leshta, brekë të bardha të gjata pambuku, përparëse me lidhëse në anën e pasme me ngjyrë të përhimë të mbyllët - trupi BA-07-121T;

xhakëtë dimri nga sintetika, pjesa e poshtme veshjeve sportive të kaltra me tri vija për së gjati të markës “ADIDAS”, pantallona nga kadifeja e përhimë me rrip lëkure ngjyrë gështenje në brez, xhemper me pulla me lara të kaltra dhe të kuqërreme, këmishë me katrorë nga flaneli i plotë me ngjyrë të zezë – gjelbër – të kuqe të mbyllët, brekë të bardha të gjata pambuku, fanellë e bardhë atletike nga pambuku, slip brekë të bardha nga pambuku, xhemper me jakë me mbërthyes zingjiri metalik - trupi BA-07-122T;

nënkishë e bardhë pambuku, xhemper i hollë i gjelbër i punuar me makinë, brekë të leshta të gjata, pjesa e poshtme e veshjeve sportive ngjyrë të përhimë, brekë të bardha të gjata pambuku, pantollona nga shtofi ngjyrë gështenje, këmishë e bardhë me vija diskrete për së gjati - trupi BA-07-115T;

një xhemper i përhimë, brekë të përhimë të gjata nga pambuku, slip brekë të bardha pambuku, çorapë e shkurtër ngjyrë të përhimë, pantallona nga pëlhura e përhimë - trupi BA-07-124T;

xhaketë e kaltër punëtorësh, xhemper i përhimë, këmishë me ngjyrë të përhimë dhe vija diskrete për së gjati, pantallona nga kadifeja e përhimë, slip brekë të bardha pambuku - trupi BA-07-125T;

xhinsa teksasi, brekë të gjata pambuku me ngjyrë të përhimë, duks me jakë me tri pulla të përhimë, xhaketë dimri nga materiali i zi sintetik, xhemper me bazë të përhimë dhe me vija të kaltra e të kuqe për së gjati - trupi BA-07-126T;

xhaketë dimri nga materiali i zi sintetik pa mëngë të djathtë e markës "MONT", pjesa e poshtme e veshjeve sportive me ngjyrë teget të markës "ADIDAS", nënkishë e bardhë pambuku, slip brekë të bardha, një çorapë e shkurtër ngjyrë të përhimë, mbeturinat e xhinsave të zi nga teksasi, fanellë-duks me roll jakë me ngjyrë të përhimë, duks me ngjyrë të përhimë - të kuqërremë - trupi BA-07-129T;

xhinsa nga teksasi i zi, duks i përhimë, pjesa e poshtme e veshjeve sportive ngjyrë të përhimë, slip brekë të bardha pambuku, fanellë e bardhë atletike nga pambuku - trupi BA-07-130T;

pjesa e poshtme e veshjeve sportive ngjyrë teget me aplikacione të kuqe të mbyllët dhe të bardha në këmbë, në kofshën e majtë gjendet mbishkrimi "BULLS", një çorapë e shkurtër ngjyrë të përhimë - trupi BA-07-132T;

xhemper me grykë-prerje të rrumbullakët rreth qafe me bazë të përhimë dhe lara të shumëta të kuqe e të kaltra, nënkishë e bardhë pambuku, xhinsa nga kadifeja e zezë me rrip të ngushtë në brez, brekë të gjata të kuqërreme - trupi BA-07-133T;

xhinsa nga kadifeja e përhimë të markës "LEVIS", jelek dimri nga materiali i zi sintetik, duks i gjelbër me grykë-prerje të rrumbullakët rreth qafe, nënkishë e bardhë me vija të zeza horizontale e vertikale, fanellë e bardhë pambuku me mëngë të gjata, xhinsa nga teksasi ngjyrë gështenje, pjesa e poshtme e veshjeve sportive pambuku me ngjyrë të zezë - trupi BA-07-136T;

xhinsa nga teksasi i zi me rrip lëkure ngjyrë gështenje në brez, fanellë e bardhë atletike nga pambuku, një palë çorapë të shkurtra me ngjyrë gështenje, slip brekë të bardha pambuku, pjesa e poshtme dhe e epërme e veshjeve sportive me ngjyrë të kaltër-përhimë me një vijë të bardhë përgjatë mëngëve dhe këmbëve me mbishkrimin "X-PRES-STEP UP YOUR IMAGE-UNLIMITED", brekë të bardha të gjata nga pambuku - trupi BA-07-137T;

xhaketë e zezë lëkure me mbërthyes zingjiri metalik, duks i gjelbër nga materiali i plotë pambuku, fanellë me bazë të bardhë, në anën e përparme ka mbishkrimin "BA-IC – CLUB", xhinsa nga teksasi i kaltër me rrip të zi në brez, brekë të bardha të gjata pambuku, slip brekë të bardha pambuku, një çorapë e leshtë me ngjyrë portokalli me lidhëse, një palë çorapë të zeza të shkurtra - trupi BA-07-139T;

xhaketë dimri nga materiali sintetik me ngjyrë të gjelbër me aplikacione ngjyrë të kuqërreme në pjesën e krahërorit, pjesa e epërme e veshjeve sportive ngjyrë të gjelbër e markës "ADIDAS", fanellë e bardhë atletike nga pambuku, një xhemper me bazë ngjyrë gështenje dhe me vija të kuqe të mbyllët dhe të kaltra në mëngë, xhemper i hollë i punuar me makinë me ngjyrë të përhimë, xhinsa nga teksasi i përhimë me rrip lëkure në brez, brekë të leshta të gjata, xhemper i përhimë, slip brekë të bardha pambuku, një palë çorapë sportive me ngjyrë të bardhë me një vijë të kuqe dhe të kaltër në grykë - trupi BA-07-144T;

brekë të gjata të zeza nga pambuku, blushalter i bardhë, xhemper ngjyrë gështenje me prerje të rrumbullakët rreth qafe, pjesa e epërme e veshjeve sportive të gjelbra nga materiali sintetik të markës "LOTTO" - trupi BA-07-148T;

xhaketë dimri e zezë lëkure ose skaji me mbërthyes zingjiri plastik, një çorapë e shkurtër e përhimë, slip brekë të bardha pambuku, fanellë e bardhë atletike nga pambuku, pjesa e poshtme e veshjeve sportive nga sintetika, meturinat e xhinsave teksas, këmishë me

katrorë të përhimë dhe të kuqërremë, një xhemper me bazë të kuqërreme me prerje të rrumbullakët rreth qafe - trupi BA-07-150T.

6. Peruqac

6.1 Ekshumimi dhe autopsia e trupave: 6 shtator deri 14 shtator 2001.

6.2 Ekipi i Akademisë Ushtarake – Mjekësore nga Beogradi:

dr. Zoran Stanković, dr. Nadica Marinković, teknik i kriminalistikës Dragutin Jovanović nga Užica.

6.3 Vëzhguesit:

Miodrag Krivokapić, qjykatës hetues i Gjyqit të Qarkut në Użice, Dragan Manović prokuror komunal në Bajina Bašta, Branimir Petronijević prokuror i qarkut në Użice, Ljubiša Radulović kryetar i Gjyqit të qarkut në Użice, Milan Radulović kryetar i Gjyqit komunal në Bajina Bašta, Mark Skinner (Mark Skinner) antropolog forenzik Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (ICMP) dhe Vladan Miladinović, Fondi për të Drejtën Humanitare.

Lokacionin e kanë vizituar Vilijam Fulton (William Fulton), hetues i Tribunalit të Hagës dhe Kris Karphamer, Silvija Panović-Gjuriq dhe Ljiljana Bogdanović - OSBE.

6.4 Terreni:

Lokacioni gjendet në grykën e lumit Derventa në liqenin Peruqac, rreth 6 kilometara nga hyrja në hidrocentralin Peruqac, ndërsa rreth 20 kilometara nga Bajina Bashta. Varreza nga e cila janë zhvarrosur trupat është me madhësi prej 6 me 4 metra dhe thellësi 1,5 deri më 2 metra.

6.5 Parametrat identifikuese:

patent shoferi dhe letërnjoftimi. Letërnjoftimi është gati tërësisht i dëmtuar, kështu që të dhënat nuk mund të lexohen. Patent shoferi është në emër të **Shkelzen Binshit**, i lindur më 29.12.1966. numri amë 2912966940014. Patent shoferi është lëshuar për kategorinë „B” dhe “C” më 29.8.1989, në Gjakovë..

6.6 Pjesët e rrobave:

Në kamionin e djegur janë gjetur pjesët e rrobave – mbeturinat e një xhakete meshkujsh nga lëkura e zezë , një batani pjesërisht e djegur si dhe rrobat që nuk janë të identifikuar që i ngjajnë mantilit ose rrobave të punëtorëve;mbeturinat e rrobave femrash; mbeturinat e rrobave fëmijësh,

6.7 Pjesë të ndryshme të mbathjeve:

një çorapë fëmijësh.

6.8 Sendet e ndyshme:

pjesë të konstrukcionit të kamionit-frigorifer me ngjyrë të gjelbër me dimensione 6 x 2,5 x 2,5 metra.

6.9 Parametrat identifikues, rroba dhe sende të gjetura në pjesët e trupi:

shufër metalike me të cilën sa ka qenë i gjallë është sanuar thyerja e nëngjunit– trupi-31.

6.10 Parametrat identifikues, rrobat dhe sendet e gjetura në trupa:¹⁷

letërnjoftimi në emër të *Gezim (Mazlu) Deva*, i lindur më 22.2.1970 në Gjakovë, me banim në rr.“Car Dushani“ nr. 3, Gjakovë, JMBG 220297094001-numri i fundit nuk mund të dallohet (ky objekt është shënuar me A2-1) – trupi D-2;

kuti me ilaçe, inhalator për hundë – trupi D-7;

proteze dhëmbësh - trupi D-8;

3 xhemper, në pjesën më të madhe i djegur – trupi D-10;

krem bluzë, duks, kapelë, çorapa dhe xhinsa – trupi D-12;

xhemper, xhaketë e kaltër, çorapë – trupi D-18;

pjesët e poshtme të veshjeve sportive ngjyrë gjelbër-kaltër – trupi D-19;

xhaketë, fanellë, xhemper, bylyzyk dore nga lëkura dhe plastika – trupi D –20;

dy palë dimi dhe një xhemper i zi – trupi D-22;

një dhëmb më tepër në mes të ashtuquajturve »dysh« dhe »tresh« të djathtë – trupi D-23;

një dhëmb më tepër në mes të ashtuquajturve »dysh« dhe »tresh« të djathtë – trupi D-25;

pjesa e poshtme e veshjeve sportive, xhemper dhe brekë meshkujsh-bokserica – trupi D-26.

7. Petrovo Selo I [PS I]

7.1 Ekshumimi dhe autopsia e trupave: 24 - 27 qershor 2001.

7.2 Ekipi i Entit të Mjekësisë Ligjore nga Nishi:

profesor dr Vujadin Otašević, profesor dr Milija Spalević, docent dr Jovan Stojanović, docent dr Lidija Kostić-Banović, docent dr Radovan Karadžić, docent dr Goran Ilić, mr Miodrag Zdravković, mr Tatjana Đorđević, dr Antović Aleksandra dhe Boško Radojković, tekniku i kriminalistikës, MPB Kladovo.

7.3 Vëzhguesit:

dr. Mark Skinner (Mark Skinner), antropolog forenzik, Komisioni Nërkomëtar për Persona të Zhdukur (ICMP) dhe Mojca Shivert, Fondi për të Drejtën Humanitare. Lokacinin e ka vizituar Vilijam Fulton hetues i Tribunalit të Hagës.

7.4 Terreni:

Lokacini gjendet në Petrovo Selo, rreth 350 metra nga ndërtesa e Qendrës për Trajnimin e Njësive Speciale të MPB RS, në anën e majtë të rrugës së fshatit në livadh. Varreza shtrihet në një sipërfaqe prej 2,50 me 3,00 metra dhe është e thellë 2,5 metra. Të gjithë trupat janë zhvarrosur nga lokacioni i afërt i varrezave masive Petrovo Selo I dhe Petrovo Selo II dhe janë varrosur në dy varreza.

7.5 Parametrat identifikues:

një copë letre në të cilën ishte i shkruar emri *Bytyqi Argon, Bytyqi Mehmed dhe Bytyqi?* (emri nuk mund të lexohet) me shenjën Chicago, America.

¹⁷ Të gjithë parametrat identifikues, rrobat dhe sendet janë shënuar me numrin e trupit në të cilin janë gjetur.

7.6 Parametrat identifikues, rrobat dhe sendet e gjetur në trupa:

Ti gjithë trupat kishin këpucë të shtresuara, nga se në çdo trup janë gjetur nga dy palë rroba të brendshme, fanella dhe xhemperë.

8. Petrovo Selo II [PS II]

8.1 Ekshumimi dhe autopsia e trupave: prej 27 qershor deri 2 korrik 2001.

8.2 Ekipi i Entit të Mjekësisë Ligjore nga Nishi:

profesor dr Vujadin Otašević, profesor dr Milija Spalević, docent dr Jovan Stojanović, docent dr Lidija Kostić-Banović, docent dr Radovan Karadžić, docent dr Goran Ilić, mr Miodrag Zdravković, mr Tatjana Đorđević, dr Antović Aleksandra dhe Boško Radojković, teknik i kriminalistikës MPB Kladovo.

8.3 Vëzhguesit:

dr. Mark Skinner (Mark Skinner), antropolog forenzik, Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (ICMP) dhe Mojca Shivert, Fondi për të Drejtën Humanitare. Lokacionin e ka vizituar Vilijam Fulton, hetuesi Tribunalit të Hagës.

8.4 Terreni:

Lokacioni gjendet rreth 250 metra nga varreza masive që është shënuar si Petrovo Selo I. Sipërfaqja e varrezës është 2,50 m me 2,00 m dhe e thellë 2,50 i 3,00 m.

8.5 Parametrat identifikues:

letërnjoftimi në emër të *Mehmeti (Man) Hysen*, i lindur më 13.3.1967. në Gjakovë; letërnjoftimi në emër të *Nazmi (Osman) Gradina*, i lindur më 1.3.1973 në Deçan.

8.6 Pjesë rrobave:

Janë gjetur pjesë të rrobave, xhemperë dhe fanella.

8.7 Parametrat identifikues, rrobat dhe sendet e gjetur në trupa:

letërnjoftimi në emër të *Selman (Jashar) Loshaj*, i lindur më 25.5.1949 nr.i Inj. 54383, JMBG 2505949924000, adresa Rr. «Boro e Ramizi» pn, Skënderaj – trupi PS-II-25; letërnjoftimi në emër të *Ilaz Musliu* nga Skënderaj, i lindur më 15.12.1948, JMBG 1512948924999;

pasaporta në emër të *Mulaj Lavdim* nga Peja, i lindur më 30.0?.1980. – është gjetur pranë një trupi të gjinisë femërore (nuk është theksuar shenja e këtij trupi).

Janë gjetur veshje dimri, xhaketa lëkure dhe xhemperë. Një trup ishte në uniformë komplete të UÇK. Dy trupa kishin të veshur jelekë luftarakë, kurse në njërin jelek gjendej flamuri gjerman.